

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6013
E shtunë, 29 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

Qeveria ndau 400 mijë euro për masa mbrojtëse kundër koronavirusit



FAQE 3

KUNDËRSHTOHET PROPOZIMI I KRYEMINISTRIT ALBIN KURTI PËR HEQJEN E TAKSËS NDAJ PRODHIMEVE SERBE

FAQE 4-5

KOSOVA PA QËNDRIM TË BASHKUAR PËR TAKSËN NDAJ SERBISË



Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kanë kundërshtuar propozimin e kryeministrit Albin Kurti për heqjen e pjesshme të taksës ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Presidenti Thaçi ka

vlerësuar se veprimet e tillë të qeverisë po e thellojnë izolimin e Kosovës dhe po i prishin raportet e Kosovës me ShBA-në. Ndërkaq zyrtarët e LDK-së kanë bërë me dije të premten se propozimi i Kurtit është bërë pa pajtim me ta. Sipas tyre,

duhet të gjendet një zgjidhje për këtë çështje që ruan raportet e Kosovës me partnerët e saj perëndimore. Analystët politikë kanë theksuar se nuk është koha për kalkulime, por për vendime të guximshme dhe në interes të vendit

Qeveria themelon grupin e ekspertëve përvetingun në drejtësi

Qeveria e Kosovës ka themeluar grupin e ekspertëve të pavarur përdizajnimin e parimeve udhëheqëse, skenarëve dhe elementeve të reformës së vetingut në sistemin e drejtësisë. Kryesues i këtij

grupi do të jetë Qerim Qerimi, ndërsa anëtarë Avni Puka, Fisnik Korenica, Visar Morina, Arbresha Loxha, Ehat Miftaraj, Ariana Qosaj-Mustafa, Arton Demhasaj, Kreshnik Gashi dhe

Kujtim Kërveshi. Po ashtu, Ministria e Drejtësisë do të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial që ta dërgojnë nga një përfaqësues në këtë grup të ekspertëve



FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
E-mail: renova@mt.net.mk


PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

OPINION

ZGJIDHJA E KONTESTIT KOSOVË
- SERBI NUK ËSHTË INTERES VETËM I YNI, POR EDHE INTERES GJEOSTRATEGJIK I ALEATËVE TANË

Shkruan:
Valon MURATI



AKTUALE

MINISTRI REKA: MSA-ja KA VENDOSUR KOSOVËN NË PROCESIN ZYRTAR PËR ANËTARËSIM NË BE

TË HËNËN MBAHET SEANCA PËR TARIFËN 100 PËR QIND

EKONOMI

QEVERIA SHKARKON BORDIN E "TREPÇËS" DHE TË "INFRAKOS"-it

KULTURË

NJË ROMAN QË E PASURON LETËRSINË SHQIPE

Prof. dr. Emin KABASHI

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

Nuk ka ende vendim për përfaqësuesin e posaçëm të BE-së për Ballkanin

BRUKESEL, 28 SHKURT - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, tha se vendet evropiane nuk kanë vendosur ende për përfaqësuesin e posaçëm të BE-së, i cili do të ngarkohej me dialogun midis Kosovës dhe Serbisë dhe me çështjet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Stano konfirmoi se ideja për emërimin e përfaqësuesit të posaçëm u është paraqitur vendeve anëtare të BE-së. "Derisa shtetet anëtare të mos

vendosin dhe miratojnë emërimin e një personi specifik për mandatin konkret, ne, as përfaqësuesi i lartë i BE-së, nuk mund të flasim për këtë", tha Stano. Komentet pasojnë deklaratën e komisionarit evropian për Zgjerim të BE-së, Oliver Varhelyi, dhënë "Radio Evropa e Lirë", se ministri i Jashtëm i Sllovenskës, Miroslav Lajçak, do të jetë përfaqësuesi i ardhshëm i BE-së për

Ballkanin Perëndimor. "Përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, është i vetmi që mund të njoftojë zyrtarisht për emërimin e një përfaqësuesi special", tha Stano.

Emërimi i përfaqësuesit të posaçëm të BE-së për Ballkanin Perëndimor pritet të bëhet më 23 mars. "Radio Evropa e Lirë" ka raportuar javën e kaluar se Borrelli e ka propozuar emrin e Lajçakut te vendet anëtare.



Përplasjet e para LSDM-BDI në prag të fushatës

Një ditë pasi LSDM-ja tha se nuk do të pranojë më kërcënimë dhe negociata joparimore nga partitë shqiptare për formimin e qeverisë pas zgjedhjeve, BDI-ja thotë se LSDM-ja duhet të jetë falënderuese që Ahmeti theu parimin fituesi me fituesin dhe i dha kah tjetër vendit

SHKUP, 28 SHKURT - Nxehen gjakrat në mes të partnerëve të koalicionit qeveritar pas zyrtarizimit të koalicionit LSDM-Besa. Një ditë pasi LSDM-ja tha se nuk do të pranojë më kërcënimë dhe negociata joparimore nga partitë shqiptare, për formimin e qeverisë pas zgjedhjeve, përgjigjet BDI-ja. Partia e Ahmetit thotë se LSDM-ja duhet të jetë falënderuese që Ahmeti theu parimin fituesi me fituesin dhe i dha kah tjetër vendit. Për pretendimet e Zaevit për mbetje të regjimit të kaluar brenda BDI-së, nënkyetari i partisë, Izet Mexhiti, thotë se e kaluara mbetet e kaluar, ka njofuar "Alsat". "Po, e vërtetë është. Ne i kushtëzuan partitë maqedonase për ta ndryshuar emrin e shtetit, për ta ndryshuar Kushtetutën, për t'u bërë pjesë e NATO-s dhe BE-së, për ta bërë këtë shtet dyguhësor, për të

pasur shqiptar kryetar Kuvendi, për ta arritur marrëveshjen me Bullgarinë. E kaluara është e kaluar. Për atë kemi kaluar zgjedhjet e kaluara parlamentare, nga ato ka dalë rezultati, populli atë që ka dashur e ka dënuar dhe ne nuk mund të mbahemi peng i të kaluarës. Me aq sa ka pasur forcë, BDI-ja çdoherë 'ka kushtëzuar' për të mirën e vendit, edhe atëherë, edhe sot, edhe në çdo qeverisje", tha Izet Mexhiti, nënkyetari i BDI-së.

Por, kreu i LSDM-së, Zaev, këmbëngul që BDI-ja duhet të ndryshojë dhe të reformohet si kusht për të qenë partner i dëshiruar për formimin e qeverisë së ardhshme. Koalicioni LSDM-Besa, sipas Zaevit, nuk e rrezikon mbështetjen e votuesve maqedonas. "Unë do t'i propozoja koalicionit tonë të partnerit të mos e gënjejë mendja. Koalicioni LSDM-BESA



dhe partitë e tjera do të jetë fitues në këto zgjedhje dhe jo BDI-ja. Në njësinë e gjashtë ku më shumë matet ndikimi i bashkësisë së dytë më të madhe etnike, bashkësisë shqiptare, këtu do të shihet fituesi. Unë e konfirmoj se ne do të jemi fitues në njësinë e gjashtë zgjedhore. Diversiteti në shtet nuk është prej sot dhe as nuk patën sukses deri ta rrezikojnë VMRO-DPMNE-ja dhe BDI-ja në atë periudhë të kaluar 11-vjeçare", tha Zoran Zaev, kryetar i LSDM-së. Ziadin Sela thotë se Aleanca për

Shqiptarët është më meritorja për të arriturat e pushtetit të kaluar. Ai nuk e sheh si rrezik koalicionin LSDM-Besa në njësinë e gjashtë zgjedhore, ku thotë se beteja gjithmonë ka qenë mes partive shqiptare. Sfida në njësinë e gjashtë, thotë Sela, do të jetë mes tij dhe Ahmetit, por ai është i bindur për fitore. "Sojuzi" i mëhershëm BDI-LSDM po kundërshton një "sojuz" të tanishëm LSDM-Lëvizja Besa. Partitë politike kanë autonominë e tyre dhe ne e respektojmë autonominë e çdo

subjekti politik, por qëndrimi ynë është që një koalicion i tillë është i gabuar, një koalicion i tillë nuk maksimalizon votën shqiptare por, përkundrazi, krijon parakusht që në një të ardhme dikush të marrë të drejtën, duke mos pasur as parti politike brenda, por vetëm ekspONENTË shqiptarë brenda, të thyejë atë parim të vendosur në vitet '90", tha Ziadin Sela. Deri tani janë zyrtarizuar koalicioni mes Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës, si dhe koalicioni mes LSDM-së dhe Besës.

Meta fton shqiptarët në shesh më 2 mars: Koha ta shpëtojmë shtetin

TIRANË, 28 SHKURT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, vijon thirrjet dhe ftesat përmes rrjeteve sociale, drejtuar shqiptarëve që t'i bashkohen manifestimit të therritur prej tij më 2 mars, në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Sipas tij, ka ardhur koha që populli ta thotë fjalën e vet kundër atyre që ai i quan puçistë dhe që kanë shkelur Kushtetutën,


shkruan "A2 CNN". "Është koha ta shpëtojmë shtetin e të gjithë shqiptarëve nga pengmarrësit e pushtetit! Ndaj më 2 mars zëri juaj duhet të dëgjohet si asnëherë tjetër. Çdo qytetar i vendit tonë duhet të kuptojë se kriza e tmerrshme institucionale, ekonomike dhe shoqërore, si dhe rritja e pasigurisë për të ardhmen, buron nga mungesa

e ndërgjegjësimit tonë si shoqëri për domosdoshmërinë e mbrojtjes së Kushtetutës nga politikanët që për më shumë pushtet ua vënë kazmën themelive të shtetit si përmes ndërhyrjeve të nxituarë dhe jotransparente, po ashtu edhe përmes bërjes së ligjeve antikushtetuese që minojnë sundimin e Kushtetutës dhe shtetit ligjor, siç është bërë tra-

ditë sidomos në vitet e fundit. Është koha që sovranit ta thotë fjalën e tij ndaj këtyre puçistëve që nxjerrin ligje për ta shkelur dhe dhunuar Kushtetutën e Republikës. Është koha ta shpëtojmë shtetin e të gjithë shqiptarëve nga pengmarrësit e pushtetit! Ndaj më 2 mars zëri juaj duhet të dëgjohet si asnëherë tjetër", ka thënë Meta.



Qeveria ndau 400 mijë euro për masa mbrojtëse kundër koronavirusit

EPOKA
ERE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 28 SHKURT - Qeveria e Republikës së Kosovës të premten ka ndarë mjete finanziare në vlerë prej 400 mijë eurosh për furnizimin me mjete mbrojtëse për profesionistët shëndetësorë dhe mjete të tjera të nevojshme për parapërgatitjen për situatën e mundshme emergjente me epideminë Coronavirusi Covid-19.

Ky vendim i qeverisë u mor pas kërkesës së ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia, i cili theksoi se këto mjete duhen me qëllim të aplikimit të rekomandimeve kryesore të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve dhe bazuar edhe në kërkesën e komitetit për monitorimin e sëmundjeve ngjitime në Kosovë. Ministri Vitia ka njoftuar të premten Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të

Kosovës si dhe ekzekutivin e vendit për masat të cilat institucionet shëndetësore i kanë ndërmarrë me qëllim të menaxhimit të situatës epidemiologjike lidhur Coronavirusin Covid-19. Një ditë më parë drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Naser Ramadani, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se Kosova i ka mobilizuar të gjitha kapacitetet e veta profesionale për t'u përballur me koronavirusin. "Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik tashmë është përgatitur dhe ka një muaj e gjysmë që i ka të gjitha dokumentet përkatëse për të gjitha aktivitetet e parandalimit. Laboratori është furnizuar dy javë pasi kanë dalë rezultatet e para prej prodhimit. Janë bërë më shumë se tri javë që IKShP është furnizuar me analiza laboratorike të nivelit më të lartë të laboratorëve më prestigjiozë evropianë. Pra, ne i kemi bërë të gjitha parapërgatitjet dhe të gjithë aktorët janë identifikuar. Mendoj se jemi të gat-

shëm që të përballemi me këtë virus", ka thënë ai. Ramadani ka ftuar qytetarët e Kosovës që të mos kenë panik, por përkujdesje ndaj epidemisë që ka goditur mbarë globin. Ai ka deklaruar se Kosova është e gatshme të përballet me këtë virus. "Mesazhi im për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës është se ata nuk duhet të kenë panik nga koronavirusi, por duhet të kenë përkujdesje. Kjo përkujdesje bëhet duke e ruajtur higjenën personale duke mos shkuar në ambiente ku ka shumë njerëz dhe mundësish të qëndrojnë në shtëpi", ka thënë ai. Ramadani ka treguar se jo çdo qytetar i prekur nga ky virus ka nevojë për ndihmë mjekësore. "Institucionet e Kosovës janë të përgatitura që t'i dalin në ndihmë çdo qytetari që ka nevojë. Mirëpo, jo çdo qytetar i cili preket nga koronavirusi ka nevojë për ndihmë mjekësore. Nevojë për ndihmë mjekësore kanë vetëm ata persona që kanë

gjendje të rëndë klinike", është shprehur Ramadani. Ai ka treguar se në parapërgatitjet që kanë bërë kanë paraparë edhe hapjen e karantinës. Koronavirusi, i identifikuar si COVID-19, e ka origjinën në qytetin Wuhan të Kinës. Rastet e para atje janë shfaqur në dhjetor të vitit të kaluar, por që atëherë dhjetëra shtete të botës kanë konfirmuar se kanë njerëz të infektuar.

Shifrat e fundit, të raportuara nga autoritetet shëndetësore të se cilës qeveri të premten në Pekin, tregojnë se koronavirusi ka infektuar mbi 83 000 njerëz në gjithë botën, ndërsa mbi 2 800 pacientë kanë vdekur.

Numri më i madh i rasteve është në Kinë, ndërsa pas saj vijnë Koreja e Jugut, Japonia, Italia, Irani, Singaporë e të tjera. Koronavirusi ka simptoma të ngjashme me pneumoninë. Shenjat kryesore të infektimit janë temperatura e lartë, kolla dhe vështirësitë në fryshtëzim.

Klinika Infektive posedon vetëm gjashtë shtretër me respirator për trajtimin e koronavirusit

Në Kosovë nuk është shënuar asnjë rast pozitiv me koronavirusin e ri. Autoritetet përgjegjëse thonë se tashmë kanë marrë të gjitha masat e duhura në rast të shfaqjes së këtij virusi në vend. Megjithëkëtë, në mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, të mbajtur të premten, anëtari i komisionit, deputeti Haxhi Avdyli, ngriti shqetësimin pasi, siç tha, në Klinikën Infektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, si qendër terciare e vetmja në Kosovë, janë vetëm gjashtë shtretër me respirator që shërbejnë për të prekurit me koronavirusi i ri.

Avdyli ka theksuar se mungesa e respiratorëve mund të paraqesë problem për trajtimin e pacientëve në rast të shfaqjes së virusit dhe përhapjes së tij. "Është bërë mobilizimi nga institucionet gjegjëse, por kapacitetet tona janë të mangëta. Ka mungesë të shtretërve për trajtim të asistuar me respirator. Janë gjashtë shtretër në dispozicion për personat me pengesa në fryshtëzim", ka deklaruar Avdyli.

Të hënën mbahet seanca për tarifën 100 për qind

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Të hënën, më 2 mars, në orën 11:00, Kuvendi, me kërkesë të 41 deputetëve, do të mbledhet në seancë të jashtëzakonshme, për të debatuar lidhur me paralajmërimin e kryeministrat të Kosovës, Albin Kurti, për heqjen e tarifës 100 për qind. Kështu vendosi Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës të premten, në mbledhjen e drejtuar nga kryetarja Vjosa Osmani, në prani edhe të

kryetarëve të grupeve parlamentare. Kryesia konstatoi se kërkesa e deputetëve për thirrjen e kësaj seance i plotëson kushtet formale-juridike prandaj, sipas praktikës, seanca do të mbahet sipas kërkesës së deputetëve nënshkrues. Po ashtu, kryesia vendosi që në pjesën e parë të marsit të mbahen edhe dy seanca të tjera të veçanta: më 5 mars, në orën 9:00, do të mbahet seancë për shënimin



e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa më

9 mars, në orën 10:00, seancë tematike për Ditën

Ndërkombëtare të Gruas. Në mbledhjen e sotme kryesia mori edhe vendime të tjera që lidhen me funksionalitetin e disa institucioneve të pavarura. Kështu, kryesia vendosi që ta publikojë shpalljen për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe autorizoi administratën e Kuvendit që t'i ndërmarrë veprimet përkatëse, sikurse edhe për dy anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave.

Kundërshtohet propozimi i kryeministrit Albin Kurti për heqjen e taksës ndaj prodhimeve serbe

KOSOVA PA QËNDRIM TË BASHKUAR PËR TAKSËN NDAJ SERBISË

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kanë kundërshtuar propozimin e kryeministrit Albin Kurti për heqjen e pjesshme të taksës ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Presidenti Thaçi ka vlerësuar se veprimet e tillë të qeverisë po e thellojnë izolimin e Kosovës dhe po i prishin raportet e Kosovës me ShBA-në. Ndërkaq zyrtarët e LDK-së kanë bërë me dije të premten se propozimi i Kurtit është bërë pa pajtim me ta. Sipas tyre, duhet të gjendet një zgjidhje për këtë çështje që ruan raportet e Kosovës me partnerët e saj perëndimorë. Analistët politikë kanë theksuar se nuk është koha për kalkulime, por për vendime të guximshme dhe në interes të vendit



Bosnjë e Hercegovina, është kundërshtuar nga ShBA-ja dhe presidenti i vendit, Hashim Thaçi. Madje ky i fundit ka deklaruar se me këto veprime qeveria e re po e thellon izolimin e Kosovës dhe ka prishur në mënyrë të ndjeshme raportet tona speciale me ShBA-në. Mbetja në fuqi e tarifës është pengesë serioze dhe e

"Kokëfortësia, mungesa e veprimeve dhe e vendimeve të mençura e ka thelluar izolimin e Kosovës dhe ka prishur në mënyrë të ndjeshme raportet tona speciale me ShBA-në. Mbetja në fuqi e tarifës është pengesë serioze dhe e

pamundëson bashkëpunimin strategjik dhe investimet e reja të fuqishme amerikane në Kosovë. Prandaj, nevoja që me urgjencë të merren vendimet e duhura ishte kërkesë dhe mesazh kryesor në takim me sekretarin Pompeo dhe me

këshilltarin për siguri nationale, O'Brien", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook". Ai e ka ftuar qeverinë që sa më shpejt ta heqë taksën dhe t'i hapë rrugë dialogut Kosovë - Serbi. "Edhe kërkesa ime e

qartë si president për qeverinë, për spektrin politik dhe, mbi të gjitha, për qytetarët e Kosovës, është që pa humbur kohë të merren vendimet e duhura strategjike, të cilat i jepin fund izolimit, i hapin mundësi dialogut përritjen e marrëveshjes përfundimtare dhe e forcën miqësinë e përhershme dhe bashkëpunimin strategjik me ShBA-në. Hezitimi eventual përvendime të shpejta, të mençura, të plota e jo të pjesshme është i panevojshëm, sepse këto vendime janë rruga e vetme për t'i arritur qëllimet tona shtetërore dhe strategjike”, ka vlerësuar Thaçi.

pjesshme e taksës nuk do të pranohet nga administrata amerikane sepse ajo nga lideria kosovar po kërkon një partner të plotë dhe jo një gjysmëpartner. Këtë partner po e kërkon për të arritur një objektiv: njohjen e ndërsjellë ndërmjet Kosovës e Serbisë, që është bërë shumë e qartë nga njeriu i parë i kësaj administrative: presidenti Trump. Zërat kritikë e dyshues shpesh çuditën pse gjithë ky presion ndaj Kosovës e jo ndaj Serbisë? Kjo do të duhej të ishte e qartë nëse zhvillimet i shohim pak përtej interesit dhe aktualitetit të tanishëm”, ka shkruar

pas t'i bëjë gjithë presionin e nevojshëm Serbisë për ta njuhur Kosovën. Kaq e thjeshtë është. Në betimin e dhënë në Kuvendin e Kosovës, deputetët dhe Qeveria e Kosovës janë zotuar se do t'i mbrojnë interesat dhe sovranitetin e Republikës. Partneriteti me ShBA-në është interes i vital i Republikës dhe këtë nuk e mohon asnjë deputet apo anëtar i qeverisë. Prandaj çdo qytetar sot ka plot të drejtë të kërkojë nga ata të zgjedhur që ta përmblushin betimin e tyre. Nuk është koha për kalkulime të momentit, por përvendime të guximshme dhe në interes të vendit”, ka shkruar Ilir Ibrahim.

Edhe analisti tjetër Blerim Latifi ka mohuar se heqja e taksës e dobëson pozicionin negocues të Kosovës me Serbinë. “Në vitin 1999 në Kosovë, përvëç mallrave serbe, ishin edhe rreth 150 mijë policë e ushtarë, por mençuria politike në Rambuje e përmbysti situatën. Pastaj, në kohën e bisedimeve në Vjenë i gjithë tregu i Kosovës ishte i pushtuar nga produktet serbe, por kjo nuk e pengoi pavarësinë e saj. Serbia mundet në tavolinën e bisedimeve, e jo në raftet e marketeve. Lërin çiftelitë politike! Bëni politikë realiste! Jemi tepër të parëndësishëm mbi faqe të dheut, që bota të merret gjithë kohën me hallet tona”, ka shkruar Latifi në profilin e vet në “Facebook”.

LDK-ja nuk pajtohet me propozimin e Kurtit

Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se propozimi i Kurtit ka ndodhur pa pajtim me LDK-në. “Unë kam qenë për t'i diskutuar kushtet. Nuk është qëndrim edhe i yni vendimi i Kurtit lidhur me taksën”, ka thënë Hoti përvet televizionin “T7”. Sipas tij, ka qenë marrëveshje e koalicionit qeverisës që të hiqet taksa dhe të zëvendësohet me masat e reciprocitetit nëse Serbia nuk reflekton me heqjen e pengesave. “Kërkesa jonë ka qenë të ulemi dhe të pajtohem i lidhur me çështjen e takës. Ne jemi qeveri dhe duhet konsensus që vendimet e qeverisë të merren së bashku. Besoj se duhet ulemi të bisedojmë”, ka thënë Hoti.

Kurse kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se është me rëndësi që partnerët e koalicionit të ulen dhe të diskutojnë në mënyrë që të merren vendime të përbashkëta. “Ajo çka është me rëndësi është që unë shoh bashkëpunim shumë të mirë nga ana e partnerëve të koalicionit. Po ashtu, shoh që të dy partnerët e koalicionit e kanë qëllimin e përbashkët. Ai qëllim i ka dy parime themelore. I pari është mbrojtja e interesave të vendit, i dyti mbrojtja e partner-

Ibrahim në llogarinë e vet në “Facebook”.

Ai ka shtuar se para 20 vjetësh ShBA-ja e bombardoi Serbinë përvet ta çliruar dhe pavarësuar Kosovën. “Sot nga kjo Kosovë, ShBA-ja e kërkon një partner 100 përvet qind përvëndur më

itetit me ShBA-në dhe BE-në, i cili është kryesor përvet ecjen përvëndit tonë”, ka thënë Osman pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit. Ajo është shprehur e bindur se, pavarësisht prej dallimeve mes partnerëve të koalicionit qeverisës, do të ruhen interesat e Kosovës dhe partneriteti me vendet që Kosova i konsideron shtete më.

ShBA-ja dhe BE-ja, qëndrime të ndryshme rreth propozimit të Kurtit

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian kanë shprehur qëndrime të ndryshme rreth heqjes së pjesshme të taksës përvet mallrat serbe. Pak orë pas propozimit të Kurtit ka reaguar i dërguari i Shtëpisë së Bardhë përvëndit. Kurti është duke bërë një gabim serioz. Ky i është qartësuar sot presidentit Hashim Thaçi në Shtëpinë e Bardhë, ka shkruar Grenell në llogarinë e vet në “Twitter”.

Por, përvet dallim nga ShBA-ja, Bashkimi Evropian e ka mirëpritur propozimin e kryeministrit të Kosovës përvet nisjen e heqjes së taksës përvet importin e lëndëve të para nga Serbia dhe nga Bosnjë dhe Hercegovina. Ky hap mund të ketë një efekt pozitiv përvet rivenosjen e tregtisë rajonale dhe të ofrojë një hapje përvet rifillimin e dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Besimi duhet të rikthehet urgjentisht. Serbia dhe Kosova duhet të krijojnë një mjedis të favorshëm që dialogu të rifillojë në dobi të të dyjave palëve”, është shprehur përvet një komunikate përvet medie, Peter Stano, zëdhënës i përfaqësuesit të lartë të

Bashkimit Evropian përvëndit të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell.

Opozita kritikon kryeministrin Kurti

Propozimi i kryeministrit përvet heqjen e taksës është kritikuar nga opozita. Udhëheqësit e qeverisë së kaluar, të cilët e kishin vendosur taksën, e kanë quajtur Kurtin mashtrues. “Albin mashtruesi u dorëzua para Serbisë. Ky është fillimi i kthimit të Serbisë dhe Rusisë në Kosovë. Albin mashtruesi nga sot je përgjegjës përvet ripushtimin ekonomik të Kosovës nga Serbia”, ka shkruar në profilin e vet në “Facebook” ish-kryeministri, njëherësht lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Kurse kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ka shkruar në llogarinë e vet në “Facebook” se propozimi i Kurtit nuk ishte asgjë e re. “Asgjë e re nga Albini! Të paktën, ta respektonte të drejtën e autorit. Sepse, vendimi i tij përvet taksën dhe reciprocitetin qenka huazuar nga ideja e propozimit të janarit të vitit 2019, të cilin, si çdo gjë tjetër, ai e pat refuzuar”, ka shkruar Veseli.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë përvet media të enjten ka prezantuar propozimin e tij se nga data 15 mars 2020 do të hiqet taksa përvet lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnjë dhe Hercegovina. Sipas tij, kjo bëhet si shenjë e vullnetit të mirë dhe gatishmërisë së Kosovës përvet fillim të zgjedhjes së mirëfilltë të mosmarrëveshjeve ekonomike, tregtare dhe politike me Serbinë.

Në paraqitjen e tij para gazetarëve, Kurti ka ftuar Serbinë që si përgjigje ndaj këtij vendimi të palës kosovare të zotohet se do të ndërpresë fushatën përvëndit e pavarësisë së Kosovës dhe, po ashtu, ta nisë eliminimin e barrierave tregtare jotarifore ndaj Kosovës.



Sot i jepet lantumira e fundit ish-luftëtarit të UÇK-së, Qerim Kelmendi

PEJË, 28 SHKURT (ER) - Sot (e shtunë) në Kompleksin Memorial në Glogjan të Deçanit, në orën 15:00, do të bëhet varrimi i ish-luftëtarit të orëve të para të UÇK-së, Qerim Kelmendi - Dema, i cili të enjten në mënyrë misterioze u vra në fshatin Zahaq të Pejës. Po sot (e shtunë) prej orës 13:00 deri në orën 14:00 do të bëhen homazhe në qendër të qytetit në Pejë, në sheshin "Shkëlzen Haradinaj".

Në orët e para të mëngjesit të ditës së enjte ish-luftëtarit i UÇK-së, Qerim Kelmendi nga fshati Llabjan i Pejës, është gjetur i vdekur brenda veturës së tij e cila ishte djegur. Sektori Rajonal i Hetimeve pranë Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë ka njoftuar se në bashkëpunim të plotë me Prokurorin e Shtetit janë duke u marrë të gjitha veprimet hetimore për t'i sqaruar rrethanat e këtij rasti të cilësuar 'vrasje'.

Për vrasjen e Qerim Kelmendit kanë reaguar përfaqësuesit e institucioneve të vendit, presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Albin Kurti, liderë partish, kryetarë komunash, OVLUÇK-ja dhe bashkëluftëtarë të Qerim Kelmendit, duke e cilësuar këtë vrasje mizore.

Ata u kanë bërë thirrje organeve



të drejtësisë që sa më shpejt ta zbardhin këtë rast. Të premten për ngushëllime në familjen Kelmendi ka shkuar ish-kryeministri dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. "Sot shpreha respektin tim për jetën


dhe veprën e bashkëluftëtarit Qerim Kelmendi. Në vizitë ngushëllimi te familja e tij në Llabjan të Pejës, krenaria mbizotëronte dhembjen e madhe", ka shkuar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Organizata 'Human Bridge' dhuron pajisje në vlerë 150 mijë euro për QKUK-në

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Shoqata humanitare "Human Bridge" nga Suedia ka dhuruar donacion në vlerë 150 mijë euro për Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK). Në donacion përfshihen shtretër, dyshekë, karrige pune dhe pajisje të tjera ortopedike, përfshirë karroca lëvizëse dhe shumë materiale të tjera të nevojshme për punë. Me rastin e dorëzim-pranimit të këtij donacioni, drejtori përgjithshëm i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka falënderuar Xhafer Balaj nga kjo organizatë u krijua në vitin 2001 përmes bashkimit të departamenteve të ndihmave të dy organizatave ndërkombëtare të ndihmës dhe zhvillimit në Suedi. Ai shprehet i lumtur që kanë arritur të sjellin këtë donacion në QKUK, duke premtuar se në vazhdimësi do të angazhohet për t'i ndihmuar edhe institucionet e tjera shëndetësore.



Tërnava i shkon në zyrë Kurtit për t'ia uruar postin e kryeministrat



PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të premten në takim kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim Tërnava. Myftiu Tërnava e uroi Kurtin për detyrën e re dhe shprehu bindjen se qeveria e re do të punojë për një të ardhme sa më të mirë për vendin duke kujtuar se sa shumë ndryshime pozitive presin qytetarët nga qeveria

Kurti. Kryeministri Kurti e falënderoi myftin për urimin dhe vizitën dhe u shpreh se është i vetëdijshëm për vështirësitë e shumta me të cilat do të përballet si kryeministër. Ai ka thënë se Qeveria është e vendosur që, pavarësisht prej vështirësive të shumta, t'u qëndrojë besnikë zotimeve të saj qeverisëse për të cilat ka marrë mbështetje masive nga qytetarët në zgjed-

hjet e 6 tetorit dhe pa të cilat nuk mund të transformohen gjendja socio-ekonomike në vend. Kurti ka thënë se numrin e ministrive e kanë zvogëluar, projektit për vitin 2020 po e përgatisin, ndërkohë që kanë filluar edhe ndryshimet e nevojshme në drejtësi. Në fund të takimit, myftiu Tërnava ka shprehur dashamirësinë e tij ndaj punës së madhe që ka filloj të bëhet me qeverinë e re.

Lumezi dhe ambasadori i Zvicrës diskutojnë për thellimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka zhvilluar një takim pune me ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jean - Hubert Lebet. Kryeprokurori Lumezi e ka njoftuar ambasadorin Lebet me të arriturat dhe sfidat gjatë viti të kaluar si dhe për planet dhe objektivat e Prokurorit të Shtetit për vitin 2020 në funksion të forcimit të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës. Në këtë kontekst, kryeprokurori i Shtetit ka dekluaruar

faktin se thelbësore për arritjen e këtyre objektivave është edhe bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, të cilët në forma dhe me projekte të ndryshme janë duke kontribuar për konsolidimin e institucioneve të drejtësisë. Ndërsa ambasadori i Zvicrës ka shprehur vlerësimin dhe mbështetjen e tij për Prokurorin e Shtetit në ushtrimin e detyrave kushtetuese dhe ligjore. Të dy bashkëbiseduesit e kanë vlerësuar të shkëlqyer



bashkëpunimin e deritanishëm në mes të institucionit

të Prokurorit të Shtetit, Ambasadës së Zvicrës në

Kosovë dhe institucioneve të drejtësisë në Zvicër, me ç'rast kanë konfirmuar vullnetin dhe gatishmërinë e dyanshme për ta avancuar edhe më tej këtë bashkëpunim, veçanërisht në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

Në fund të takimit, kryeprokurori Lumezi ka shprehur falënderim për shtetin e Zvicrës, duke e çmuar lart ndihmën dhe përkrahjen e dhënë nga ambasadori Lebet për institucionin e Prokurorit të Shtetit.

Qeveria themelon grupin e ekspertëve për vetingun në drejtësi

Qeveria e Kosovës ka themeluar grupin e ekspertëve të pavarur për dizajnimin e parimeve udhëheqëse, skenarëve dhe elementeve të reformës së vetingut në sistemin e drejtësisë. Kryesues i këtij grupei do të jetë Qerim Qerimi, kurse anëtarë Avni Puka, Fisnik Korenica, Visar Morina, Arbresha Loxha, Ehat Miftaraj, Ariana Qosaj-Mustafa, Arton Demhasaj, Kreshnik Gashi dhe Kujtim Kërveshi. Po ashtu, Ministria e Drejtësisë do të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial që ta dërgojnë nga një përfaqësues në këtë grup të ekspertëve

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që të themelohet grupi i ekspertëve të pavarur për draftimin e skenarëve dhe elementeve të reformës së vetingut në sistemin e drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e ka arsyetuar para kabinetit qeveritar të premtën propozimin për themelimin e

grupit të ekspertëve të pavarur për reformën e vetingut në sistemin e drejtësisë ku ka treguar edhe detyrat e tyre. "Si ministre e Drejtësisë, në përpjegje me programin qeverisës dhe në kuadër të reformave në drejtësi, më lejoni që ta propozoj themelimin e grupit të ekspertëve të pavarur për t'i dizajnuar parimet udhëheqëse, skenarët dhe elementet e reformës së vetingut në sistemin e

drejtësisë. Grupi i ekspertëve do të ketë mandat për këto çështje: të ofrojë studim kuptimplotë, të thelluar dhe të argumentuar, mbi mundësitë e rifillimit të një procesi të vetingut në sistemin e drejtësisë në Kosovë, të ofrojë një pasqyrë të qartë të skenarëve - nga më i thelluari deri te më sipërfaqësori mbi të cilët mund të bazohet reforma e vetingut të sistemit të drejtësisë në dritën e së Drejtës Kushtetuese dhe sistemit ligjor

të Kosovës, parimeve ndërkombëtare të pavarësisë, paanshmërisë, integrititetit dhe profesionalizmit të funksionit gjyqësor dhe prokurorial të së drejtës për të drejtat e njeriut, kryesishët të bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. T'i përcaktojë elementet e reformës së vetingut në sistemin e drejtësisë sipas secilit skenar të identifikuar dhe t'i identifikojë rreziqet, mundësitë, përparësitet dhe dobësitë e secilit skenar të studiuar. Ta përcaktojë metodën e përfshirjes konstitutive të elementit ndërkombëtar në procesin e vetingut dhe mënyrën se si duhet ushtruar përpjekja për ta ndërtuar konsensusin parlamentar për një ndryshim të tillë madhor, si dhe të identifikojë raste të suksesshme të krahasueshme

dhe t'i pasqyrojë elementet e dobishme që mund të përfshihen në reformën e vetingut në Kosovë", ka thënë ajo.

Ministrja Haxhiu ka thënë se grupi i ekspertëve deri më 30 maj duhet t'i paraqesë Ministrisë së Drejtësisë dhe Qeverisë së Kosovës raportin me skenarët e studiuar për reformën e vetingut në sistemin e drejtësisë. Kryesues i këtij grupei të ekspertëve të pavarur do të jetë Qerim Qerimi, kurse anëtarë të tjerë do të janë: Avni Puka, Fisnik Korenica, Visar Morina, Arbresha Loxha, Ehat Miftaraj, Ariana Qosaj-Mustafa, Arton Demhasaj, Kreshnik Gashi dhe Kujtim Kërveshi. Anëtar i grupit të ekspertëve për vetingun në drejtësi do të jetë edhe një përfaqësues i Këshillit Prokurorial dhe një i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.



Ministri Reka: MSA-ja ka vendosur Kosovën në procesin zyrtar për anëtarësim në BE

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 SHKURT - Ministri i Integrimit Evropian, Blerim Reka, ka marrë pjesë të premtën në panelin për të diskutuar përraundin e radhës për Fondet e Para Anëtarësimit të BE-së, IPA III. Gjatë këtij diskutimi u prezantua studimi "Udhërrëfyesi për IPA III: Mësimet, risitë dhe hapat e ardhshëm".

Në fjalën e ti ministri Reka evidentoi proceset aktuale që Kosova është duke kaluar me agjendën evropiane ku në aspektin afatshkurtër prioriteti i jepet prites së vendimit pozitiv

të Këshillit të BE-së për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Gjithashtu, ai ka thënë se Marrëveshja e Stabilizim Asocimil ka vendosur Kosovën në procesin zyrtar për anëtarësim në BE. Në këtë drejtim e rikujojmë kontributin e madh për periudhën e fundit financiare të BE-së 2014-2017, me ç'rast Kosova ka përfituar 602 milionë euro.

Ministri Reka, po ashtu, ritheksoi se Qeveria e Kosovës e ka integrimin evropian prioritet strategjik si dhe, bazuar në sondazhet paraprake, rreth 90 për qind e qytetarëve të Kosovës



mbështesin anëtarësimin në BE. "Qeveria e Kosovës shumë shpejt do ta miratojë programin qeverisës dhe prioritetet kyçë do të janë në harmoni me agjendën evropiane. Kjo nënkupton që në koordinim me delegacionin e BE-së në Kosovë do të bëhet edhe hartimi dhe programimi i fondeve për IPA III, në mënyrë që të janë në përpjegje të plotë me programin e qeverisë", ka thënë Reka. Ky aktivitet u organizua nga Instituti EPIK dhe mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), në Europe House, e cila financohet Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Klubi i Prodhesve përkrah vendimin e qeverisë për largimin e taksës

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Klubi i Prodhesve të Kosovës e përkrah vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për largimin e tarifës 100 për qind për produktet që importohen nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. "Ne si Klub jemi prapa çdo vendimi i cili do t'i mbronte dhe avanconte interesat shtetërore të Kosovës. Të

gjitha vendimet duhet të merren në bashkëpunim të ngushtë me ShBA-në dhe BE-në. Shpresojmë shumë se largimi i tarifës 100 për qind do të vlerësohet si shenjë e vullnetit të mirë dhe gatishmërisë për fillimin e zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve ekonomike, tregtare dhe politike me Serbinë. Gjithashtu, shpresojmë se kjo

masë do të rezultojë me eliminimin e të gjithave barrierave tregtare si ato tarifore dhe jotorifore, po ashtu të krijojë mundësinë që përfundimisht të krijohen marrëdhënie për tregtë të lirë me Serbinë e cila mbështetet në parime të ndërsjella", thuhet në komunikatën për media të Klubit të Prodhesve të Kosovës.



KLUBI I PRODHESVE TË KOSOV
KOSOVO MANUFACTURING CLU

OEAK-u: Digjitalizimi, proces i pashmangshëm për bizneset

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Digjitalizimi është një praktikë e domosdoshme për rritjen e transparencës dhe efikasitetit të punës në biznese si dhe zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomik të vendit. Kjo u tha të premten në një tryezë të diskutimit mbi digjitalizimin afarist në vend, të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Milot Arifi, drejtor ekzekutiv i "Prosperoware", ka deklaruar se në Kosovë të gjitha kompanitë me ose pa vetëdije janë duke iu nënshtruar revolucionit digital, i cili sjellë në vete mundësi të shumta, por edhe sfida të ndryshme. Sipas tij, është shumë e rëndësishme që çdo kompani ta nisë këtë proces, duke filluar së pari me promovimin e një kulture në organizatë e cila e përqafon iniciativën, duke shtuar se ka shumë hapësirë për ngritje të vetëdijes mbi proceset digitale dhe përfitimet nga ato te bizneset e Kosovës.

Getoar Mjeku, këshilltar i ministres së Ekonomisë, foli për programin katërvjeçar të qeverisë për ekonominë digjitalë në vend, ku tha se qëllimi kryesor i këtij programi është që t'i financojë komponentët kyçë të transformimit digjital.

Mjeku e përmendi mungesën e legjisacionit si një ndër barrierat e mëparshme për zhvillim të këtij sektori, gjersa theksoi se qeveria po fillon implementimin e një projekti për rritjen e konkurrueshmerinë në sektorin e teknologjisë informative. Sipas tij, qeveria do të ketë prioritet krijimin e një infrastrukturë digitale të mbështetur edhe me legjisacion adekuat, sidomos për tregtinë online.

Agim Bekaj, përfaqësues i kompanisë "Microsoft", tha se në vitet e fundit në përgjithësi popullsia e Kosovës penetron në masë të madhe në rrjetë sociale, gjë që tregon një trend në rritje, prandaj bizneset e Kosovës




domosdoshmërisht duhet të jenë në hap me trendët modernë dhe të kenë prani të shtuar në botën digitale. Më tutje, Bekaj e konsideroi shumë të rëndësishëm digjitalizimin e shërbimeve për qytetarë nga qeveria sepse, sipas tij, ky do t'i minimizonte

mundësitë për praktika si korrupsioni. Taulant Stublla nga kompania "Cisco" tha se digjitalizimi është një proces i një rëndësie të veçantë, i cili duhet të ekzistojë brenda çdo biznesi, sepse në rastin e kompanive të Kosovës ai, mes të tjerash, e mundëson lehtazi edhe ofrimin e shërbimeve jashtë vendit. Stublla theksoi se digjitalizimi ndikon në lehtësimin e punës në institucione qoftë publike apo private, ndërsa qeveria duhet të bëjë më shumë mbi rregullimin e kornizave ligjore të cilat do ta mbështesin digjitalizimin.

Mbi 200 mijë qytetarë përfituan nga investimet e KEDS-it në vitin 2019

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Mbi 200 mijë qytetarë kanë përfituar nga investimet e KEDS-it të kryera gjatë vitit 2019. Sipas njoftimit për media nga KEDS-i, ky vit ka qenë periudha me më së shumti realizime të projekteve investuese në nivel të Kosovës që nga fillimi i operimit të kompanisë. "Fokusi i investimeve ishte në lokalitetet ku gjendja e trashëguar e rrjetit distributiv ishte në gjendje më të rëndë. Specifikisht, numri më i madh i projekteve u realizua në Podujevë, Drenas, Prishtinë, Ferizaj, Deçan, Fushë-Kosovë dhe Gjakovë. KEDS-i në këto rajone ka zbatuar projekte të mëdha investive që drejtëpërdrejt ndikojnë në furnizim kualitativ e stabil për ekonomitë familjare dhe biznesore në këto anë. Rrjeti elektrik në këto lokalitete tashmë ka pamje tjetër, në standartet më të larta", është



thënë në këtë njoftim.

Kostoja totale e realizimit të

këtyre projekteve kap shifrën 16,6 milionë euro, prej tyre mbi

11 milionë euro janë për tensionin e ulët dhe mbi 5,5

millionë euro për tensionin e mesëm. "Kjo shumë ka bërë që të shtrihen mbi 1200 kilometra rrjet i ri i të gjitha llojeve të rrjetit distributiv, duke përfshirë edhe vendosjen e afro 400 trafove. KEDS-i që nga privatizimi i distribucionit ka bërë shumë investime në sistemin e rrjetit elektrik në Kosovë dhe kjo ka ndikuar dukshëm në cilësinë dhe furnizim të rregullt me energji elektrike. KEDS-i ka marrë përsipër që për 15 vjet të investojë 300 milionë euro", është theksuar në njoftimin e KEDS-it.

KEDS-i për gjashtë vjet ka investuar 146 milionë euro, ka realizuar 714 projekte investive në rrjetin e tensionit të ulët dhe të mesëm dhe 816 projekte në përfecmin e rrjetit dhe mirëmbajte. Gjatë kësaj periudhe përfituan 140 mijë konsumatorë apo mbi gjysmë milioni qytetarë të Kosovës.

Qeveria shkarkon bordin e 'Trepçës' dhe të 'Infrakos'-it



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka shkarkuar të premten bordin e "Trepçës" dhe bordin e drejtoreve të ndërmarrjes që merret me menaxhimin e hekurudhave "Infrakos".

Ministrja e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Rozeta Hajdari, ka thënë se propozimi për shkarkimin e bordit të "Trepçës" jetet duke u mbështetur dhe duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës. "Qeveria si ushtruese e detyrës emëron 6 nga 9 drejtoret në bordin mbikëqyrës dhe të njëjtë mund t'i shkarkojë nëse ekzistojnë arsyet. Në rastin e 'Trepçës' tërsia e rrëthanave rreth palujtshmërisë bie ndesh me interesat e ndërmarrjes", ka thënë Hajdari.

Me vendimin për shkarkimin e bordit të "Trepçës", qeveria ka

shkarkuar gjashtë drejtore mbikëqyrës të kësaj ndërmarrje. Po ashtu, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të premten për ta shkarkuar bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore "Hekurudhat e Kosovës - Infrakos".

Ministrja Hajdari i propozoi kabinetit qeveritar shkarkimin e bordit të "Infrakos"-it për shkak se nuk e ka shkarkuar kryshefin Agron Thaçi pas ngritjes së aktakuzës që i është bërë atij. "Bordi ka shkelur detyrat për shkak se ka dështuar të marrë masa ndaj kryeshefit të ndërmarrjes, i akuzuar për keqpërdorim të pozitës më 3 janar 2020. Prokuroria e Prizrenit, Departamenti për Krimë të Rëndë, ka ngritur aktakuzë ndaj Agron Thaçit për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Bordi ka njoftuar se ka shqyrtuar rastin, por kanë thënë se nuk duan të interferojnë në punët e drejtësisë. Bordi s'ka nevojë të presë. Bordi është vonuar pa

arsye në përbushjen e detyrimeve ligjore", ka thënë ministri Hajdari.

Në mbledhjen e së premtes, Qeveria e Kosovës ka shfuqizuar koncept-dokumentin për ndryshimin e politikave fiskale dhe bujqësore për prodhimin e duhanit dhe cigareve në Kosovë si dhe çështjen që ka të bëjë me normën e akcizës për cigaret e prodhua në Kosovë. Vendimet në fjalë janë shfuqizuar me arsyetimin se po ndikojnë negativisht në të hyrat nga akcizat.

Vendimi për akcizën ka të bëjë me favorizimin që i bëhej biznesit të duhanit të këshilltarit të Ramush Haradinajt, Gazmend Abrashit, i cili ishte një prej këshilltarëve kryesorë të kryeministrat të asaj kohe. Gazmend Abrashi ka 92 për qind të aksioneve në "Premium Tobacco Group", fabrikë e vetme për prodhimin e cigareve në Kosovë. Atë e kishte privatizuar

200 mijë euro të zotuara nga Qeveria e Kosovës në Konferencën e Donatorëve për mbështetjen e Shqipërisë për përballimin e pasojave nga tërmeti i fundvitit të kaluar janë ndarë të premten në mbledhjen e qeverisë. Mjetet do të merren nga kontingjenti i mjeteve në Ministrinë e Financave në kategorinë e shpenzimeve dhe mallrave. Këto mjete do të transferohen në llogarinë zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

në vitin 2013 dhe biznesi ka për veprimtari edhe tregtinë me cigare dhe duhan.

Ministri i Financave, Besnik Bislimi, ka arsyetuar nevojën për shfuqizimin e këtyre vendimeve. "Të hyrat nga akciza janë ndikuar negativisht nga ky vendim. Duke marrë parasysh se është vetëm një fabrikë e duhanit në vend, e ka bërë këtë vendim shumë

preferencial dhe të pabazuar në analiza paraprake", ka thënë ministri Bislimi, duke shtuar se ky propozim, për t'i shfuqizuar këto vendime, është në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat si dhe trajtimit të barabartë dhe të drejtë për të gjithë. Në mbledhjen e kaluar kabinetit qeveritar ka shkarkuar edhe Bordin e Telekomit të Kosovës.

Qalaj dhe Prestreshi nënshkruajnë memorandum për kontolle të paparalajmëruara

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës (AKK), Valon Prestreshi, dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, kanë nënshkruar të premten një memorandum bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve, me qëllim të shtimit të koordinimit mes palëve për adresimin e shkeljeve të mundshme të konkurrencës. "Ky dokument i rëndësishëm parasheh bashkëpunimin në mes të palëve në fusha të ndryshme, përfshirë këtu shkëmbimin e informacionit, bashkërendimin e aktiviteteve, trajnimin dhe vëtëdijesimin e të tjera", thuhet

në njoftimin e AKK-së. Në njoftimin për media thuhet se një nga pikat kryesore të këtij memorandumi ka të bëjë me bashkëpunimin për kryerjen e kontrolleve të paparalajmëruara (apo siç njihet gjërësisht në gjuhën angleze si "dawn raids") te subjektet e dyshuara për shkelje të konkurrencës. Sipas këtij njoftimi, kjo nënkuption që zyrtarët e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës kërkojnë një autorizim nga gjykata kompetente për të hyrë pa paralajmërim ose leje të veçantë në selinë dhe pronat e subjekteve të dyshuara, si dhe mund të kërkojnë asistencë nga zyrtarët e Policisë së Kosovës në



raste specifike. Kryetari i AKK-së, Valon Prestreshi, ka mirëpritur nënshkrimin e këtij dokumenti që, sipas tij, krijon mundësi shpeshtë për Autoritetin që të parandalojë çfarëdo shkelje të mundshme të konkurrencës në Kosovë. Ai ka falënderuar Qalajn për gatishmërinë e tij për nënshkrimin e këtij dokumenti të rëndësishëm. Kurse Qalaj ka deklaruar se Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar që t'i ndihmojë të gjitha institucionet e vendit për ta zbatuar misionin e tyre të përcaktuar me ligjet në fuqi. Sipas tij, ky memorandum do ta lehtësojë komunikimin dhe bashkëpunimin mes dy palëve.

Skenderaj dhe Drenasi përkujtojnë betejën e Qirezit dhe të Likoshanit

SKENDERAJ, 28 SHKURT (ER) - Komuna e Skenderajt, së bashku me Komunën e Drenasit dhe Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së, kanë shënuar 22-vjetorin e betejës së Qirezit e të Likoshanit, duke kujtuar luftën e UÇK-së, dëshmorët Rexhep Rexhepi, Beqir Rexhepi, Muhamet Gjeli dhe Naser Gjeli, civilët e pafajshëm të vrarë nga forcat serbe në Qirez e Likoshan. Me këtë rast, nënkyetari i Komunës

së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, së bashku me kryetarin e Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së, familjarë të të rënëve e qytetarë bënë homazhe e vendosen lule te varrezat e të rënëve e martirëve të lirisë. Ata të premtën kanë bërë edhe zbulimin e pllakës përkujtimore në kullën e Muhamet e Naser Gjelit dhe në kullën e Brahim Rexhepit.



Komuna e Kamenicës lanson platformën digitale për rritjen e transparencës

KAMENICË, 28 SHKURT (ER) - Për ta rritur transparencën në vendimarrje, Komuna e Kamenicës ka lansuar platformën digitale. Kjo komunë ka theksuar se platforma digitale u mundëson qytetarëve të Kamenicës që online t'i adresojnë problemet, kërkesat, ankesat apo idetë e tyre duke iu ofruar komunikim të drejtë me zyrtarët komunalë. "Ndërsa problemet, idetë ose çështjet e ngritura nga

qytetarët do të mund të votohen nga komuniteti dhe nga votat e tyre, ku pastaj komuna do të kupojë se cilat janë prioritetet e atij lokaliteti. Përveç problemeve, kjo platformë u mundëson qytetarëve



edhe të propozojnë projekte dhe ide të ndryshme për komunitetin ku ata jetojnë. Viziton platformën digitale dhe komunikoni drejtësore me komunën tuaj. Kërko në shtëpi, përfito në shtëpi!. Regjistrohuni përmes e-mailit, 'Facebook'-ut, 'Instagram'-ut dhe 'Twitter'-ut <https://platformadigitale.com/Kamenica>", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.

Gjini takohet me zëvendësministren e Arsimit të Shqipërisë, flasin për bashkëpunim

Gjakovë, 28 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka pritur të premtën në takim zëvendësministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë, Lorena Haxhiu. Në

këtë takim, kryetari Gjini dhe zëvendësministrja Haxhiu kanë biseduar për zhvillimet aktuale në fushat e arsimit, sportit dhe rinisë si dhe për bashkëpunimet eventuale në të ardhmen në këto fusha.



Komuna e Mitrovicës dhe IADK-u vazhdojnë mbështetjen e fermerëve

MITROVICË, 28 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ekrem Sadiku, ka pritur në një takim drejtorin e IADK-së, Zenel Bunjaku, me të cilin kanë nënshkruar aneksin e parë të marrëveshjes përbashkëfinancim të projektit përkrahje të fermerëve me serra dhe ngritjen e njësisë përgatitjen e ëmbëlsirave.

Me nënshkrimin e këtij aneksi të marrëveshjes do të përfitojnë gjashtë fermerë përdërtimin e serrave me sipërfaqe prej 100 metresh katrorë, një fermer përgatitje të ëmbëlsirave dhe tre studentë përpunë praktike. Ky projekt në tërësi kap shumën prej 26 780 eurosh, nga të cilat IADK-u do t'i gurojë 72 përqind, komuna



19 përqind dhe fermerët 3 përqind të mjeteve. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka falënderuar drejtorin e IADK-së përbashkëpuni të ndërsjellë dhe të frytshëm, falë të cilit në bujqësinë e kësaj komune janë realizuar një varg projekte të rendësishme që kanë ndikuar në shtimin e interesimit të fermerëve përtu marrë me bujqësi. Ndërsa drejtori ekzekutiv i IADK-së, Zenel Bunjaku, e ka vlerësuar të sukseshëm bashkëpunimin me Komunën e Mitrovicës.

Drejtoria e Inspeksionit në Mitrovicë rrënon një objekt afarist të ndërtuar në pronë publike



MITROVICË, 28 SHKURT (ER) - Drejtoria e Inspeksionit në Komunën e Mitrovicës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, të premtën ka bërë rrënimin e një objekti afarist të ndërtuar pa leje ndërtimi në pronë publike në rrugën "Bislim Bajgora". Për ta përcjellë nga afër procesin e rrënimit ishin të pranishëm edhe kryetari i Komunës, Agim Bahtiri, drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, si

dhe drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Nehat Bahtiri. Kryetari i komunës, Agim Bahtiri, bën të ditur se ky vendim është në përputhje me ligjin dhe se uzurpimi i pronës publike dhe ndërtimi pa leje është një vepër e rëndë që, krahas kësaj, çdo shkelës i këtyre rregullave, përpos rrënimit, mund të përballet edhe me organet e drejtësise. Po ashtu, kryetari Bahtiri potencon se me kohë e

kanë paralajmëruar ndërtuesin si dhe kanë ndjekur të gjitha procedurat deri në vendimin përfundimtar përrënim. Drejtoria e Inspeksionit u ka bërë thirje të gjithë qytetarëve të cilët duan të bëjnë ndërtimi të objekteve afariste apo të banimit që të pajisen me leje ndërtimi, përndryshe Inspektorati i Komunës është i obliguar që ta zbatojë ligjin dhe të marrë masa në përputhje të ligjit në fuqi.

Juniku përkujton doktor Abaz Krasniqin në njëvjetorin e vdekjes

Junik, 28 shkurt (ER) - Komuna e Junikut ka përkujtuar doktor Abaz Krasniqin në njëvjetorin e ndarjes nga jetë. Me këtë rast, kjo

komunë ka theksuar se kujtimi për doktor Krasniqin do të mbetet gjithmonë i freskët. "Komuna e Junikut, kolegët dhe bashkëpunëtorin, dr. Abaz Krasniqi,

torët, në njëvjetorin e ndarjes fizike kujtojnë doktorin, veprimtarin, humanistin, kolegun dhe bashkëpunëtorin, dr. Abaz Krasniqi.

Kujtimi për dr. Abazin do të mbetet gjithmonë i freskët!", ka njoftuar Komuna e Junikut, e cila drejtohet nga Agron Kuçi.



Zgjidhja e kontestit Kosovë - Serbi nuk është interes vetëm i yni, por edhe interes gjeostrategjik i aleatëve tanë



Shkruan: Valon MURATI

Një marrëveshje që do të përfundonte me zgjidhjen e problemeve me Serbinë është parakusht jo vetëm i konsolidimit të shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, por edhe i krijimit të kushteve objektive për t'u përqendruar në agjendën e zhvillimit ekonomik.

luftimit të korruptionit, sundimit të ligjit etj. Në këtë drejtim qeveritë tonë vijnë në pushtet me prentime për zhvillimin ekonomik, sundimin e ligjit e luftimin e korruptionit, ndërsa në realitet puna e parë që i pret është dialogu me Serbinë. Dy qeveritë para kësaj që është sot, qeveria Mustafa dhe ajo Haradinaj, para zgjedhjeve dhe në ditët e para të qeverisjes i ka karakterizuar synimi që të merren më shumë me agjendën e brendshme. Por jo vetëm që ato do të mbahen mend për kontekstin e marrëdhënieve të jashtme dhe dialogun me Serbinë (e para për problemet rreth asocacionit të

komunave serbe dhe demarkacionit me Malin e Zi dhe e dyta për tarifën ndaj Serbisë dhe rrjedhimisht pengesave rreth procesit të dialogut), por në fund edhe ranë për shkak të atij konteksti. E vetmja gjë që i ka dalluar është jetëgjatësia. E para ka zgjatur pak më shumë se e dyta. Edhe qeveria aktuale, edhe pse është përpjekur në vazhdimësi të theksojë se agjenda e saj kryesore nuk janë bisedimet me Serbinë, por zhvillimet e brendshme, është ditur që në fillim se puna e parë serioze që do ta presë këtë qeveri është çështja e tarifës ndaj Serbisë dhe rrjedhimisht dialogu me

Serbinë. Vetëm naivët dhe partitë tona politike për interesa të ngushta e përfshitime afatshkurtra e kanë injoruar në vazhdimësi çështjen e dialogut, përfshirë edhe në fushatën e fundit zgjedhore. Pak njerëz e kanë lexuar dhe trajtuar me seriozitet letrën e presidentit Tramp dhe përkushtimin amerikan që t'i japid një zgjidhje dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pak njerëz ende po e kuptojnë se nuk jemi vetëm ne në pyetje, por interesa më të thella gjeo-strategjike dhe, fatmirësisht, ne vazhdojmë të jemi në anën atyre që vazhdojnë të na konsiderojnë aleatë të natyrshëm në

rirreshtimet gjeostrategjike për shkak të forcimit të Ruseve dhe Kinës. Andaj qeveria Kurti jo vetëm nëse dëshiron t'ia zgjasë vetes jetën, por edhe nëse është e interesuar vërtet të punojë për interesat e Kosovës, duhet ta gjejë rrugën e duhur të bashkëpunimit me faktorin amerikan dhe atë evropian dhe duke u bërë pjesë e procesit të dialogut, të bëjë përpjekje ta shtyjë përpara një zgjidhje të mirë, që nuk do të na linte problemin brenda dhe kështu duke zgjidhur problemin me Serbinë, t'ia hapë Kosovës, kombit shqiptar dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës, perspektivat e zhvillimit

“Pjetër Bogdani” do t'i prezantojë në Leipzig botimet e Kosovës

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” edhe këtë vit, ashtu si në vitin e kaluar, do të marrë pjesë në Panairin e Librit në Leipzig të Gjermanisë. Pjesëmarrjen e saj do të mbështesë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës.

Për një përfaqësim sa më gjithëpërfshirës dhe të denjë, Biblioteka Kombëtare u ka shkruar një letër të gjithë botuesve të Kosovës, nga të cilët ka kërkuar propozim të tituje të përzgjedhur të botimeve të tyre, cines kriterieve të mëposhtme:

sipas kriterieve te meposhtme:
“Botime te Kosovës në gjuhën
shqipe të viteve 2018-2020, deri
të 3-të i së shtunë”

ne 3 tituj nga 3 kopje;
Botime të Kosovës të përkthyera
nga gjuhë të huaja në gjuhën
shqipe, të viteve 2010-2020, deri
në 5 tituj nga 3 kopje:

Ille 3 tituj ligjë 3 kopje,
Botime të Kosovës në gjuhë të
tjera, të viteve 2010-2020, deri në
5 tituj nga 2 kopje.

5 tituj nga 3 kopje.
Të gjitha veprat që do të
propozohen nga ju do të
ekspozohen në stendën e
Bibliotekës Kombëtare të
Kosovës në Panairin e Librit në



Leipzig si dhe do të ofrohen për shitje sipas çmimit që do t'ua vënë botuesit. Mjetet financiare nga shitja e veprave do t'i dorëzohen botuesit pas përfundimit të panairit, ndërsa veprat që mbresin të pashitura do t'u kthehen botuesve", është thënë në letrën e Bibliotekës Kombëtare dërguar botuesve.

Po ashtu, Biblioteka Kombëtare e Kosovës ka njoftuar se është duke përgatitur një katalog, i cili do t'i përfshijë të dhënrat e botuesve dhe të botimeve të përzgjedhura nga botuesit për pjesëmarrje në Panairin e Librit në Leipzig. “Qëllimi i këtij katalogu është krijimi i mundësisë së bashkëpunimit ndërmjet

botuesve të Kosovës me botues ndërkombëtarë, sidomos në fushën e përkthimeve", është thënë në letrën e Bibliotekës Kombëtare, e cila, ndër të tjera, ka kërkuar që të plotësohet formulari me të dhënat e titujve të librave të autorëve shqiptarë dhe të huaj, të cilin pastaj botuesit duhet t'ia dërgojnë së

njëjtës në formë elektronike deri më 04.03.2020 në e-mail adresën: info.bkk@rks-gov.net. Ndërkaq, titujt që botuesit i raportojnë në formularin për eksposizim në Panairin e Librit në Leipzig duhet të dorëzohen në formë fizike deri më 04.03.2020 në Zyrën e Pranimit në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

Kosova e Kroacia fuqizojnë bashkëpunimin në shëndetësi

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) -
Ministri i Shëndetësisë i Republikës së Kosovës, Arben Vitia, ka pritur të premten në takim ambasadoren e Republikës së Kroacisë në Kosovë, Danijela Barisiq. Gjatë takimit me ambasadoren Barisiq, ministri Vitia ka falën-

deruar shtetin e Kroacisë për ndihmën dhënë Kosovës në rrafshin politik dhe në sektorin e shëndetësor dhe ka shprehur përkushtimin përfundimtar e këtij bashkëpunimi. Kosova dhe Kroacia kanë marrëveshje bashkëpunimi në shëndetësi dhe bashkëbiseduesit kanë

shprehur gatishmérinë përfuqizimin e këtij bashkëpunimi në rrafshin e avancimit të shërbimeve të reja dhe ngritjes së nivelit të profesionistëve shëndetësorë me qëllim që qytetarëve të vendit t'u sigurohen shërbime shëndetësore cilësore dhe të sigurta.



Rritet numri i të vdekurve nga koronavirusi në Itali

ROMË, 28 SHKURT - Rritet bilanci i të vdekurve nga koronavirusi në Itali. Deri të premtën në mbrëmje numri i të vdekurve ka shkuar në 21 dhe atyre të prekur në 821. Lajmin e ka bërë të ditur gjatë një konference për shtyp Angelo Borrelli, komisionari

për mbrojtjen civile në Itali. Ndërkohë, janë 345 persona që po kurohen në spital, ndërsa 422 të tjerë janë duke u kuruar në shtëpi. 64 prej të prekurve janë në terapi intensive. Nga ana tjetër, deri më tanë ekzistojnë 151 raste me koron-

avirus në Veneto, sipas përditësimit më të fundit të lëshuar nga ky rajon. Shpërthimi më i madh me të prekur mbetet ai i Vo 'Euganeo, me 70 raste, i ndjekur nga Treviso me 23, pastaj Venecia me 10, Limena me 9, Milano me 5 dhe Vicenza me 3.



NATO-ja u bënë thirrje Rusisë dhe Sirisë të ndalin ofensivën në Idlib



Propozimi për një zonë ndalim-fluturimi erdhë disa orë pasi forcat e Qeverisë siriane vranë 33 ushtarë turq në Sirinë verilindore.

Goditja shënon një shkallëzim në konfliktin mes forcave turke dhe atyre siriane të mbështetura nga Rusia, që nga fillimi i shkurtit.

Departamenti amerikan i Mbrotjes tha se Sekretari Mark Esper foli me homologun e tij turk të enjten për të diskutuar gjendjen në Idlib dhe Libi. "Ne po shqyrtojmë mënyra se si Shtetet e Bashkuara mund të punojnë së bashku me Turqinë dhe komunitetin ndërkombëtar", tha Pentagoni duke iu referuar telefonatës.

Bisedimet diplomatike mes Turqisë dhe Rusisë në Ankara përfunduan pa zgjidhje të enjten.

Luftimet në Idlib janë shkallëzuar dhe pritet të shtohen më tej, ndërsa Ankaraja i ka dhënë ultimatum Damaskut që të tërhiqet deri në fund të shkurtit.

Kombet e Bashkuara thonë se afro një milion sirianë janë zhvendosur nga luftimet e fundit në Idlib. Qindra-mija refugiatë kanë shkuar drejt kufirit me Turqinë.

Turqia po mban 3.5 milionë sirianë dhe presidenti Erdogan ka paralajmëruar vazhdimisht se Turqia nuk mund të pranojë refugiatë të tjerë. Një zyrtar i lartë turk tha se Ankaraja nuk do t'i ndalojë më refugiatë që ikin prej konfliktit, që të nisen për në Evropë.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se aleatët dënojnë goditjet ajrore të vazhdueshme dhe pa dallim nga regjimi sirian dhe Rusia në rajonin Idlib dhe u bëjmë thirrje ta ndalojnë ofensivën, ta respektojnë ligjin ndërkombëtar dhe t'i mbështesin përpjekjet e OKB-së për një zgjidhje paqësore

BRUKSEL, 28 SHKURT - NATO-ja u bëri të premtën thirrje Rusisë dhe Sirisë ta ndalin ofensivën në Idlib dhe tha se aleanca qëndron në solidaritet me Turqinë, pasi 33 ushtarë turq humbën jetën në një goditje ajrore të forcave ajrore siriane, ndërsa situata është përshkallëzuar. Ndërkohë presidenti rus Vladimir Putin dhe homologu i tij turk Rexhep Tajip Erdogan patën të premtën një bisedë telefonike për të

diskutuar për ngjarjen. Turqia bëri thirrje të premtën për një zonë ndërkombëtare të sigurt ndalim-fluturimi në Siri për t'i mbrojtur civilët, ka njoftuar voa. Ambasadorët e vendeve të NATO-s mbajtën bisedime urgjente me kërkësën e Turqisë, vend anëtar i aleancës, pas goditjeve ajrore. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, foli pas takimit. "Aleatët dënojnë goditjet

ajrore të vazhdueshme dhe pa dallim nga regjimi sirian dhe Rusia në rajonin Idlib. U bëj thirrje ta ndalojnë ofensivën, ta respektojnë ligjin ndërkombëtar dhe t'i mbështesin përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për një zgjidhje paqësore", tha ai. Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, tha se presidentët Putin dhe Erdogan biseduan të premtën lidhur me zbatimin e marrëveshjeve për provincën

Idlib, mes tensioneve në rritje. "Nëse marrëveshet do të ishin respektuar plotësisht, përfshirë komunikimin lidhur me vendndodhjen e saktë të forcave turke, tragedi të tillë mund të ishin shhangur", tha Lavrov i një konferencë për shtyp me ministrin e Jashtëm të Luksemburgut, Jean Asselborn. Ai tha se Rusia dhe Turqia ishin të gatshme ta vazhdonin bashkërendimin.

Turqia hap kufijtë për refugjatët që duan të hyjnë në BE

ANKARA, 28 SHKURT - Refugjatët në Turqi ua mësynë kufijve evropianë të premtën, pasi një zyrtar turk deklaroi se kufijtë janë hapur, në përgjigje të përshkallëzimit të luftës në Siri. Të enjten 33 ushtarë turq u vranë nga forcat qeveritare siriane, të mbështetura nga Rusia. "Kemi marrë vendim, i cili hyn në fuqi menjëherë, që të mos i ndalojmë refugjatët sirianë nga shkuaria në Evropë, qoftë përmes tokës ose detit", tha një zyrtar i lartë turk për agjencinë e lajmeve "Reuters". "Të gjithë

refugjatët, përfshirë sirianët, mund të kalojnë në Bashkimin Evropian", tha zyrtari turk në kushte anonimiteti.

Reuters raporton se, brenda orësh, kolona migrantësh janë nisur drejt kufijve evropianë. "Kemi dëgjuar për hapje të kufijve në televizion", tha Sahin Nebizade, migrante afgane. Greqia dhe Bullgaria thanë se i kanë forcuar kontrollot në kufij menjëherë.

Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, tha se perspektiva e një krize të re migrantësh

paraqet një kërcënim të madh në kohën kur vendet evropiane janë duke luftuar me përhapjen e koronavirusit COVID-19.

Megjithatë, BE-ja dhe Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatë thanë se raportet për çdo ndryshim të gjendjes në kufij janë ende jozyrtare dhe se Ankaraja nuk ka bërë ndonjë njoftim zyrtar.

Turqia, në vitin 2016, ka nënshkuar një marrëveshje me Bashkimin Evropian për të penguar rrjedhën e migrantëve - të ikur kryesisht nga konfliktet



në Lindjen e Mesme - në vendet e BE-së.

Një vit më herët, më 2015, Evropa është përballur me

krizën më të madhe me migrantë që nga Lufta e Dytë Botërore, pasi mbi një milion shish kanë hyrë në kontinent.

NJË ROMAN QË E PASURON LETËRSINË SHQIPE

Lufi Dervishi, "Violina e humbur", LShK, Prishtinë, 2019

Prof. dr. Emin KABASHI

Romani "Violina e humbur" i autorit dr. Lutfi Dervishi i përket familjes së romanit modern jo vetëm me shtjellimin e ngjarjeve, ku prania e rrëfyesit është e padukshme jo vetëm për përshtimin e njëjtë të kohës dhe të hapësirës të cilat nuk hetohen, jo vetëm me praninë e realitetit objektiv që shndërrohet në realitet imagjinar, por edhe me paraqitjen e personazheve si bartës të veprimit të ngjarjeve, pra jo vetëm si kundrues të tyre. Do të thotë, romani i dr. Lutfi Dervishit lexohet me tëndje, zgjon përherë kureshtjen e lexuesit si dhe jep informacion të shumtë për ngjarjet në të cilat veprojnë personazhet e tij.

Një rrëfim epik me shtresë imë të mrekullueshme lirike

Nuk është aspak me rëndësi se kur dhe në cilat rrethana e ka shkruar romanin "Violina e humbur", autori i tij, dr. Lutfi Dervishi. Nëse nuk shpërfaqen në faqet e romanit krajetat e jetës së tij, atëherë të gjithë kapitujt e këtij romani rrëfejnë edhe për jetën e tij, për ngjarjet nëpër të cilat ka kaluar, situatat që i janë bërë pjesë e jetës, rrethanat jetësore, që ndonjëherë dinë të janë njerkë e jetës së njeriut, pa marrë parasysh se prania e autorit fshihet pas bartësve të ngjarjeve, pra pas jetës së personazheve të tij. Dhe kjo është një karakteristikë e romanit modern, pra edhe e romanit modern shqiptar.

Romani i dr. Lutfi Dervishit, "Violina e humbur", është një rrëfim epik, me shtresime të mrekullueshme lirike, që e bëjnë jo vetëm të lexueshmë, jo vetëm të kuptueshmë, por edhe ngacmon kërkësinë e lexuesit, provokon deri në padurim aftësinë e tij për të kuptuar të gjitha shtresimet e rrëfimit të personazheve të këtij romani. Kjo është një anë tjetër e romanit modern shqiptar.

Jeta e violinistit të njohur Jon Dreni, sado që personazhimagjinari, siç i kërkon edhe metodologja e ndërtimit të një proze, paraqet me gjuhën e rrëfimit, fatet jetësore, rëniet dhe ngritjet e një shtrese të caktuar intelektuale në Kosovë. Prandaj, mund të thuhet, e veçanta e ndërtimit të këtij personazhi, është fakti se ai jepet si një përfaqësues i një shtrese të re të inteligencies shqiptare që po krijohej në Kosovë, kurse personazhi i Jon Drenit, në

roman del si një përfaqësues tipik i aristokracisë kulturore dhe intelektuale shqiptare, gjë që shoqërinë tonë e kishte marrë malli ta kishte që më shumë se një gjysmë shekulli, ndoshta me ndërpërje të shkurtra kohore, që nga aristokracia e Motit të Madh të Skënderbeut.

Veprimi i personazheve në ndërtimin e ngjarjeve në roman


Personazhet e romanit "Violina e humbur" krijojnë dhe ndërtojnë ngjarjet me veprimin e tyre, andaj është aq i pranishëm dialogu në strukturën tekstore të romanit. Karakteristikë tjetër e romanit "Violina e humbur" të autorit dr. Lutfi Dervishi, është se zhvillimi i ngjarjeve, krijimi i situatave, si dhe rrëfimi i skenave krijuhet përmes veprimit të personazheve, herë duke qenë të pranishëm fizikisht, herë përmes episodeve të rikujtimeve, pra të rikrijimit të ngjarjeve të ndryshme, që kanë ndodhur nëpër periudha të caktuara kohore. Koha dhe hapësira, si elementë të strukturës së romanit, janë të pandashme, andaj as autori, as personazhet e romanit të tij, nuk lodhen shumë për të definuar këta përbërës të strukturës së romanit.

Paraqitura e Jon Drenit nëpër faqet e këtij romani të kujton jetën në terti të cilën kanë kaluar intelektualë të njohur të jetës sonë, pa marrë parasysh profesionet që kanë pasur, por skenat dhe prapaskenat e jetës së tij zhvillohen herë sipas imaginatës së autorit, herë sipas rrjedhës së ngjarjeve jetësore që i kishin rënë hise.

Të kujtojmë me këtë rast, vdekjen e dashurisë së tij të madhe, gruas Elit, si dhe shurdhërinë e vajzës së tij Ronës, shkaktuar nga aksidenti në të cilin kishte humbur jetën nëna e saj.

Pas një jete thuaqse të idilit familjar, humbja e jetës së Elit, gruas që e kishte dashur shumë Jon Dreni dhe shurdhërisë së vajzës së tij, që bëhet bartëse e kujtimit të pranisë së të emrës në jetën e babait të saj, vijnë thuaqse papritur, kurse autori nuk mérzitet që të bëjë argumentin për ngjarjen, siç ndodh në teatër, por vetëm jep përmasën dhembjes dhe të tragedisë jetësore të Jonit.

Qoftë vetëm ky episode të bën të mendosh, se pa marrë parasysh kur ngjarjet janë të kurdisura, apo janë reale, me rëndësi është aftësia krijuese, gjuha e rrëfimit të krijuiesit, si dhe përgjedhja e situatave nëpër të cilat ka



shtjelluar rrugën jetësore të personazhit kryesor të romanit të tij, Jon Drenit.

Kjo përblysje e menjëherësme në jetën e personazheve të romanit të tij, jep të kuptohet se jeta ka të mirat dhe të këqijat e saj, me të cilat është marrë autori i romanit "Violina e humbur", duke i vënë bartës të atyre ngjarjeve personazhet e tij. Pra, ai fshihet pas bartësve të ngjarjeve. Nuk është rrëfimtar, është vetëm dëshmitar, nëse mund të përkufizohet në këtë mënyrë, qasja e lexuesit në punë të rrëfimit të ngjarjeve dhe veprimit të personazheve në këtë roman.

Në secilin kapitull të romanit, veprojnë shumë personazhe të tjerë, kush më shumë i pranishëm, kush më pak, por që të gjithë përplotësojnë, jetën, veprimet dhe ngjarjet jetësore nëpër të cilat kalon Jon Dreni, si bartës kryesor i rrëfimit në romanin "Violina e humbur".

Do të thotë, ngjarjet në roman kanë një shtjellim, në formë të kronikës së rrëfimit, pa u lodhur shumë se a është strukturë e mirëfilltë e romanit modern. Prania e madhe e skenave lirike, pra e rrëfimit të ngjarjeve me gjuhën e personazheve, jo duke vepruar, por duke rikujtuar, shkërmorë praninë e kronikës, edhe për faktin se bëjnë që rrëfimi të jetë i freskët, i realizuar mirë artistikisht dhe shumë i pranishëm në jetën e lexuesit.

Kjo veçanti e këtij romani, e ka shpëtuar atë nga niveli i kronikës së romanit historik, gjë që nuk është romani "Violina e humbur", nga niveli i rrëfimit të ngjarjeve, sipas llogarive të krijuiesit, apo sipas kërkësave të redaktorëve që më shumë i besojnë teorizimit të metodologjive të krijuimit të romanit, se sa gjuhës së rrëfimit në një roman, që ka jetën brenda.

Romani i dr. Lutfi Dervishit ka plotë jetë brenda. Personazhet e

tij, nuk ikin nga të papriturat e jetës, nuk i thyejnë vështirësitë e jetës, nuk dorëzohen nga prapaskenat e kurdisura, por bëjnë përpjekje ti jalin jetës kuptim, qoftë edhe atëherë kur shpresa përblyset, ose kur rrugët jetësore është vështirë të gjenden, që të ecet vertikalishët nëpër to.

Në romanin e Lutfi Dervishit ka një galeri të tërë personazhesh, kush më shumë e kush më pak i pranishëm, por të gjithë së bashku përbëjnë mozaikun e rrëfimit të ngjarjeve, janë bartës të veprimit të situatave, dhe në fund të fundit, janë secili botë e brendshme me vete.

Ka një specifikë, në pjesën më të madhe të personazheve, se ato janë të shtresave të larta të jetës kulturore në Prishtinë e kohës kur autori i ka vendosur ngjarjet e romanit të tij. Përashtime mund të bëjnë Rona e vogël, e ndonjë personazh tjetër, atykëtu, por në tërësi, bartës të ngjarjeve dhe veprimeve janë kjo shtresë e intelektualëve të kulturës.

Ndonjë prani, herë pas here e ndonjë mjeku, apo e ndonjë personazhi tjetër, sikur thyen atë një trajtshmërinë e veprimtarisë së personazheve të këtij romani.

Nga ana tjetër, pikërisht kjo rrëthanë specifike e kësaj poetike të romanit "Violina e humbur", e sendërtuar si praktikë shkrimi edhe përmes magjisë shkrimore të pranisë dhe jo pranisë së pamjeve, herë reale dhe herë estetike, e kombinuar me qartësinë e të shkruarit, pra me gjuhën e rrëfimit të ngjarjeve dhe me gjuhën e personazheve si bartës të atyre ngjarjeve, na shkon mendja për të thënë, se autori e distancon veten nga karakteret që ka krijuar në këtë roman.

Romani "Violina e humbur" i dr. Lutfi Dervishit, pjesa më e madhe e rrëfimit të ngjarjeve e realizuar bindshëm, shënon një dëshmi të pranisë dhe pasurisë së kuptimit të bukurisë së jetës, pa marrë parasysh rrokullisjet e fateve njerëzore, që i përcjellin edhe personazhet e këtij romani, aq shpesh përkundër tmerrit që di të kurdis jeta, në terti të rrëfimit vjen si një shenjë e qartë e ndërlidhjes së jetës së njeriut, me familjen, me rrëthin ku zhvillon veprimtarinë e tij, me mjedisin shoqëror, me jetën e tij intime, por edhe me prapaskenat që di të kurdisin njerëzit dhe jeta në përgjithësi.

Po ashtu, personazhet e romanit "Violina e humbur", edhe këtë mënyrë të rrëfimit të ngjarjeve, siç është thënë më sipër, ku mbisundon dialogu i

personazheve si bartës të veprimit të ngjarjeve, jo si kundrues pasiv të tyre, në një anë, por edhe si një fakt të ligjërimit modern, që lexohet dhe shijohet, siç thotë Harold Bloom, në librin "Si dhe përsë të lexojmë", për kënaqësi estetike dhe tjetësimi shpirtëror (2008:153), që që ngjet me lemin dhe rileximin e ngjarjeve të këtij romani.

Një rrëfim i personazheve në ndërtimin e ngjarjeve

Veprimi i personazheve në rrëfimin e ndërtimin e ngjarjeve së romanin "Violina e humbur" të autorit dr. Lutfi Dervishi, aq shpesh shpalon anën njerëzore tronditëse, sidomos në mënyrë të veçantë me skenat e dashurisë, ndikon sadopak për të zbehur dhe mërguar tmerrin e prapaskenave të jetës dhe kurdisjet e fateve njerëzore.

Personazhi kryesor i romanit, sipas hapësirës së strukturës së tekstit, është pjesë e dashurive të mëdha, si ajo për Elin, gruan e parë që humb jetën në aksident, krejt papritur dhe krejt befashëm, dhe për jetën e Jon Drenit, edhe për kërkëshinë e lexuesit, duke ia lënë pengun e madh të dashurisë vajzën që mbetet me të meta në dëgjim, Ronën, por kur nuk e pret fare, në jetën e tij hyn Eni, njeriu që sërisht i jep kuptim jetës së tij, duke e kthyer nëpër kravatat e jetës, pastaj po ashtu papritur, hyn Emi, që bëhet edhe pjesë e veprimtarisë së tij artistike.

Romani "Violina e humbur" rrëfen ngjarje, që në një mënyrë a në një tjetër, vetë krijuiesi i ka dhënë që në titullin e romanit. Andaj, sikur thotë, këtu është dhënë jeta e një artisti të violinës, që bëhet bartës i aspiratave të intelektualit shqiptar, në rrëthana të caktuara jetësore, ku herë vezullon nga lumturia, herë përblyset me kokë poshtë nga mjerimi që i kurdis jeta.

Ngjarjet zhvillohet kryesisht në vetën e tretë, ku në qendër të romanit është personazhi i Jon Drenit.

Romani "Violina e humbur", i autorit dr. Lutfi Dervishi, ia vlen të lexohet, edhe për faktin se ka një rrëfim i personazheve së romanit "Violina e humbur", i cili përfshin edhe personazhet e këtij romani, aq shpesh përkundër tmerrit që di të kurdis jeta, në terti të rrëfimit vjen si një shenjë e qartë e ndërlidhjes së jetës së njeriut, me familjen, me rrëthin ku zhvillon veprimtarinë e tij, me mjedisin shoqëror, me jetën e tij intime, por edhe me prapaskenat që di të kurdisin njerëzit dhe jeta në përgjithësi. Po ashtu, personazhet e romanit "Violina e humbur", edhe këtë mënyrë të rrëfimit të ngjarjeve, siç është thënë më sipër, ku jeta e intelektualit ka rëniet dhe ngjitjet e tij, skenat dhe prapaskenat e shoqërisë, por edhe botën e tij të brendshme që, mendoj unë, është realizuar mirë në këtë roman.

E jashtëzakonshme**Zhytësi italian takohet ballë përballë me anakondat 7 metërshe që peshojnë rreth 100 kilogramë**

Fotografi italian Bartolomeo Bove ka pasion të madh për kriesat nënurore. Ai jo vetëm se është zhytës profesionist që argëtohet me peshkaqen por, gjithashtu, ai udhëton nëpër botë për të filmuar gjëra të ndryshme dhe përvojat i shpërndanë në kanalin zyrtar në "YouTube". Në korrik të vitit të kaluar Bove



udhëtoi në Brazil, ku filmoi gjarprin më të madh në botë, anakondën legjendare me ngjyrë të gjelbër. Bove dhe partneri i tij i zhytjes Juca Ygarape gjetën dy anakonda mbi 7 metra të gjata dhe që peshojnë 100 kilogramë. Ky fakt nuk i frikësoi aspak ata, përkundrazi u argëtuan me anakondat.

FOTO E DITES

Fëmijët indianë shihen duke kryer një stërvitje tradicionale. /AP/

E rrallë**Policia e Moskës arreston 'Batman'-in dhe i konfiskon makinën**

Të gjithë të pasionuarit pas filmave me heron kanë të ndërruar njëherë në jetën e tyre që të janë si ata. Por kjo i ka kushtuar shtrenjtë një 32-vjeçari në Moskë, i cili kishte modifikuar vetë makinën e tij për ta bërë të ngjashme me atë që përdor Batman. Makina e quajtur



'Batmobile' u ndalua nga autoritetet të cilët deklarojnë se ajo shkel rregullat e sigurisë në rrugë. Sipas 'BBC'-së, përmbrasat e automjetit janë jashtë standartit të një makine normale dhe kjo përbën rrezik në qarkullim. Policia këtij 32-vjeçari ia ka konfiskuar makinën.



DASHI
Përkushtohuni ndaj një projekti që

dëshironi të realizoni me gjithë forcën tuaj. Është koha për t'i arritur qëllimet tuaja.



DEMI
Energjia dhe pasioni janë

ndërthurur pozitivisht me shpresën për ta goditur objektivin tuaj dhe, mbase, edhe të fitoni një çmim.



BINJAKËT
Tani keni mjaft kohë për t'u çlodhur, për

të rimenduar dhe për të lexuar një libër të mirë. Merreni shtruar, do të krijuhet një mundësi për të hequr një pengesë.



GAFORRJA
Ju mund të filloni nisma të reja, me

sigurinë se me kalimin e kohës ata do të jepin fryte. Një projekt vërtetë se keni një mik të vërtetë dhe do të merni shumë kënaqësi në fund.



LUANI
Do të keni një ndjenjë intolerance që së pari

nuk mund të arrini ta kapni. Mundohuni të pajtoheni me pasqyrën, nëse nuk ju pëlqen imazhi që do të shihni dhe bëhuni më pak intrigant me veten.



VIRGJËRESHA
Intuita juaj do të dëshmojë të jetë e saktë. Në

fushën sentimentale, më në fund, do ta rregulloni një marrëdhëniet ku ditët e fundit, ka shkaktuar shqetësimë dhe disa momente pasigurie.



PESHORJA
Plot pritje! Marrëdhënia në çift mund

të ketë disa konflikte, por dialogu dhe komunikimi, jo vetëm verbal, do të ketë shumë efekt pozitiv.



AKREPI
Të gjithë ata rreth jush shfaqen

si armiq! Kushtojini vëmendje mirëqenies suaj duke zgjedhur atë që ju siguron kënaqësi dhe relaksim.



SHIGJETARI
Nuk ka asnjë lajm të madh, por një rutinë

në e heshtur dhe një zell i mirë që dëshmon produktiv në një nivel praktik. Përfitonin nga koha juaj e lirë për t'i kushtuar vëmendje trupit.



BRICJAPI
Asnjë re në qillin tuaj nga pikëpamja

sentimentale: partneri juaj do t'ju ndjekë në të gjitha aspektet. Përmirësoni aftësinë tuaj fizike dhe estetike.



UJORI
Në punët e caktuara për këtë ditë do të

tregoheni intuitiv dhe të mençur, do të arrini sukses dhe do të ndiheni shumë të vlerësuar. Probleme pagjumësie? Trajtojeni veten për një të diel pushuese.



PESHQIT
Shijoni këtë ditë të luntur, plot stimuj të rind, tërheqës dhe perspektive të favorshme! Me sfondin e muzikës romantike, mbërmja do të jetë e këndshme me një bashkëpunëtor do të përjetoni një intimitet të vluar.

BARSOLETA E DITËS

Një fëmijë i vogël rrihet nga fqinja. Nëna e tij shumë e nevrikosur shkon për t'i kërkuar shpjegime:

- A mund ta di pse e ke rrahur djalin tim?
- Pasi është i paedukuar. Më tha trashaluqe.
- Dhe çfarë mendoni ju zonjë, se duke e rrahur djalin tim do të dobësoheni?

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC****Në ora 18:00
Spies in Disguise 3D**

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno

**Në ora 18:00
Jumanji; The Next Level 3D**

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan

**Çdo natë në ora 20:00
STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D**

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj


Regjia: J.J. Abrams

**Çdo natë në ora 22:30
THE GRUDGE**

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea DuVall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

Mabel po kërkon “të dashur” në këngën e re



Mabel u rikthy me muzikë të re. Këngëtarja 23-vjeçare nga Anglia ka publikuar këngën e re "Boyfriend" mbi takat e momentit të saj të bujshëm në BRIT Awards 2020, ku ajo fitoi çmimin për Solo Artisten më të mirë

femër. "E kam shkruar këtë këngë me ekipin e ëndrrave kamille dhe rockstoneprod për t'ua rikujuar të gjithëve se të dëshiruarit të dikujt në jetën tuaj nuk do të thotë se sërisht s'mund të jesh ajo bitch", ka shkruar Mabelnë një postim në "Instagram".

Demi Lovato poston fotografi pa grim



Demi Lovato ka vendosur t'i tregojë të gjitha. Këngëtarja e "Anyone" e ka postuar në "Instagram" një fotografi ku është krejtësisht pa grim, duke dashur kështu që t'u tregojë ndjekësve se si duket fytyra e saj e vërtetë. "Nuk e kam postuar një fotografi pa grim

për shumë vite me radhë, por e kuptova që pasi kam postuar kaq shumë fotografi glamuroze ku jam shumë e grimuar dhe me flokët e stiluara, është shumë e rëndësishme që ta shfaq atë që fshihet pas krejt kësaj, fytyrën time të vërtetë", ka shkruar ajo poshtë fotografisë.



Bella Hadid pozon me 'binjaken' e saj Carla Bruni për "Elle France"

Bella Hadid më në fund e ka realizuar ëndrrën për të pozuar për ballinën e një reviste me idolin e saj Carla Bruni. Modeluesja 23-vjeçare vazhdimesht ka qenë shumë e hapur duke treguar përfiksimin e saj me


supermodeluesen dhe ish-Zonjën e Parë të Francës. Hadid dhe Bruni që ngjajnë jashtëzakonisht shumë kanë pozuar së bashku për ballinën e numrit më të ri të revistës "Elle France".

Princi Harry këndon me Jon Bon Jovi



Princi Harry ka kënduar të premten bashkë me yllin e muzikës rok, Jon Bon Jovi, në studiot e famshme botërore "Abbey Road". Atje muzikanti amerikan po regjistrion këngën

"Unbroken" me korin e Fondacionit "Invictus Games". Harry, i cili do të tërhiqet nga detyra mbretërore në fund të marsit, ka postuar video në rrjetet sociale gjatë regjistrimit të këngës.



Dallku: Prishtina gjithmonë luan për fitore Munishi: Ballkani është skuadër më e fortë

Trajneri Armend Dallku ka deklaruar, para ndeshjes derbi kundër Ballkanit, se Prishtina në çdo ndeshje hyn për fitore, kurse trajneri Ismet Munishi është i bindur se skuadra e tij është më e fortë se ajo kryeqytetase. Përbalja në mes të këtyre skuadra zhvillohet sot, me fillim nga ora 17:00, në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë

EPOKA ERE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 28 SHKURT - Skuadra më e madhe në Kosovë, Prishtina, është e përgatitur maksimalisht për derbin ndaj skuadrës lidere, Ballkanit. Përbalja në mes të këtyre dy skuadra, që pretendojnë të shpalen kampione në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, zhvillohet sot (e shtunë) në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 17:00.

Trajneri Armend Dallku ka thënë se Prishtina do të luajë ashtu sikurse në çdo ndeshje për fitore. "Ballkani nuk bën përjashtim nga kundërshtarët e tjerë. Ne jemi duke analizuar kundërshtarin dhe lojën tonë, por nuk është diçka e jashtëzakonshme dhe ndeshje që vendos gjithçka. Ne jemi Prishtina dhe në çdo ndeshje hyjmë fitore", ka deklaruar trajneri "bardhekaltë". Ndërsa kapiteni Armend Thaqi ka deklaruar se skuadra kampione e

vjeshtës, Ballkani, nuk është skuadër e pamposhtur. "Jemi në formë të mirë dhe mendoj se do të fitojmë kundër Ballkanit, pasi nuk është skuadër e pamposhtur. Fusha është e përshtatshme për lojë dhe mbetet të shihet se a do t'i arkëtojmë tri pikët", ka deklaruar ai. Skuadra nga Suhareka, që është mobilizuar për ndeshjen që e zhvillon në kryeqytet, ka mbajtur edhe një konferencë përmëdia. Trajneri Ismet Munishi është i bindur se skuadra e tij është me e fortë se Prishtina. "Për lojën brenë pa modë them se jemi skuadër e fortë, por kemi respektin ndaj Prishtinës, sepse është skuadra më e trofeshme në vend dhe këtë edicion po tregon lojë cilësore, duke treguar edhe ngritje pas ardhjes së Dallikut, ku vërehet përmirësim tek ta. Ne nuk do të frikësohem i dhe jemi optimistë përmët këtë sfidë", ka thënë Munishi. Në konferencë përmëdia është



paraqitur edhe kapiteni Visar Berisha, i cili në të kaluarën ka qenë edhe kapiten i Prishtinës. "Prishtina është një ekip që lufton përmë trofe, kurse ne jemi ekip i ri në elitë, kemi synimet e tona përmë dalë në Evropë. Unë besoj në cilësinë tonë që do t'ia arrijmë t'ia dalim", ka deklaruar Berisha. Nëndëshja që zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" e ka analizuar edhe trajneri Musa Selimi, i cili përgazetën "Epoka e re" ka deklaruar se kjo përbalje do të jetë ndërmë interesantë në vitet e fundit përfaktin se të dyja këto skuadra janë duke luftuar përmë titull. "Do të jetë një ndeshje e jashtëzakonshme. Përballen dy klubet që e synojnë titullin në këtë edicion. Ballkani ka treguar formë të mirë dhe nëse e fiton këtë ndeshje do të jetë edhe më afér qëllimit. Prishtina ka përmët këtë ndeshje", ka deklaruar Berisha.

parësinë e terrenit dhe traditës. E mira e gjithë kësaj është se tifozët do ta kenë rastin të shohin një ndeshje të jashtëzakonshme", ka thënë Selimi. Skuadra "bardhekaltë" ka njofuar edhe përmë çmimin e biletave, i cili sillet nga 2 deri në 5 euro. Bileta do të dalin në shitje sot (e shtunë) nga ora 11:00 rrëth stadiumit "Fadil Vokrri".

Drita triumfon ndaj Drenicës

Drita e ka fituar përbaljen me Drenicën (4-1), e cila është zhvilluar të premten në Gjilan. Vendësit nga fillimi e deri në fund e patën kontrollin e lojës dhe me meritë morën tri pikë. Kastriot Rexha ishte në formë të lartë në këtë ndeshje dhe realizoi dy gola në pjesën e parë, kurse një tjetër e

IPKO Superliga	
Drita-Drenica	4-1
Të shtunën takohen:	
13:00 Ferizaj - Llapë	
13:00 Feronikeli - Trepça '89	
13:00 Dukagjini - Gjilanë	
17:00 Prishtina - Ballkani	
Të dielën takohen:	
13:00 Flamurtari - Vushtrria	
LIGA E PARË	
Të shtunën takohen:	
Istogu - Drenasi	
Vitia - Malisheva	
Të dielën takohen:	
Vllaznia - KEK-u	
Trepça - Onix	
Arberia - 2 Korriku	
Liria - Ulpiana	
Vellaznimi - Ramiz Sadiku	
Dardana - Besa	

shtoi Betim Haxhimusa, derisa kuqezinjtë nga Skenderaj shënuan golin e vetëm në pjesën e dytë nëpërmjet Alban Shillovës përmë rezultatin 3-1, kurse rezultatin final (4-1) e vulosi Emini në fund të ndeshjes. Pas kësaj fitore, Drita barazohet me pikë me Ballkanin që është në vend të parë, kurse Drenica mbetet në kuotën e 24 pikëve dhe renditet në pozitën e tetë. Për shkak të reshjeve të borës dhe erërave të forta është shtyrë përmë shtunën ndeshja në mes të Ferizajt dhe Llapit.

Përurohet shtatorja e Majlinda Kelmendit

Shtatorja e kampiones olimpike Majlinda Kelmendi është përvuara të premten në qytetin e Pejës. Të pranishëm ishin kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani; ministri e MKRS-së, Vlora Dumoshi; kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani; kryetari i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos, Marius Vizer dhe ish-kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj.



PEJË, 28 SHKURT (ER) - Në qytetin e Pejës, në vendlindjen e saj, është bërë përvimi i shtatorës së kampiones olimpike në xhudo, Majlinda Kelmendi, e cila është mbështetur e realizuar nga Federata Ndërkombëtare e Xhudos. Në ceremoni të organizuar enkas përmët ngjarje morën pjesë personalitetë të shumta të jetës sportive e politike të vendit, ndërsa kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ministrija e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani dhe kryetari i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos, Marius Vizer, i cili ka ardhur përmë ta përvuru-

ar shtatoreni e xhudistes Majlinda Kelmendi. Ministria Dumoshi ka thënë se me punën e tyre Majlinda Kelmendi e Driton Kuka na kanë bërë krenarë të gjithëve dhe uroi xhudisten Kelmendi përmë shtatorën e saj, duke e vlerësuar si heroinë të gjallë. "Ne si Ministri e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në Lojërat Olimpikë u dëshiroj sukses dhe uroj që të gjithë të kthehen me medalje nga Tokyo", ka thënë Dumoshi, duke konsideruar se suksesi në xhudo nuk është i rastësishëm, por përmë shkak të shpirtit luftarak. Ndërsa kryetarja Osmani ka deklaruar: "Pavarësisht prej sfidave

xhudisteve që do të marrin pjesë në Lojërat Olimpikë u dëshiroj sukses dhe uroj që të gjithë të kthehen me medalje nga Tokyo", ka thënë Dumoshi, duke konsideruar se suksesi në xhudo nuk është i rastësishëm, por përmë shkak të shpirtit luftarak. Ndërsa kryetarja Osmani ka deklaruar: "Pavarësisht prej sfidave

dhe problemeve që mund të hasin na kanë dëshmuar se mund të rrezohemi edhe si popull dhe të ringritemi edhe 1 000 herë nëse është nevoja. E ngritet vendin aty ku ne si politikan nuk mundëm kurrë. Rinia ka qenë shumë hapa para nesh. Ka ardhur koha që edhe institucionet të vijnë në hapin tênd e ta bëjnë krenar vendin". Kryetari i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos, Marius Vizer, ka thënë se Majlinda Kelmendi, trajneri Diton Kuka dhe ekipi i xhudos u bënë shtyllat më të forta të krenarisë dhe identitetit tonë shtetëror. "Kënaqësi e veçantë të isha pjesëmarrës sot në Pejë gjatë zbulimit të shtatorës së kampiones olimpike evropiane, Majlinda Kelmendi, triumfit e së cilës u shndërruan në fitore të jashtëzakonshme përmë Kosovën. Majlinda, së bashku me trajnerin Driton Kuka dhe gjithë ekipi i xhudos, përmes punës së shkëlqyeshme u bënë shtyllat më të forta të krenarisë dhe identitetit tonë shtetëror. Gjithnjë në mbështetje të yjeve tanë sportivë", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".


Interi dhe Unitedi me fat, Roma ‘peshkon’ Sevillan

NION, 28 SHKURT - Shorti i hedhur në Nion të Zvicrës ka përcaktuar çiftet që do të sfidohen në raundin tjetër të turneut të dytë për nga rëndësia në futbollin evropian për klube, Ligën e Evropës. Goglat ishin me fat

për Interin, që do të luajë kundër Getafes, ndërsa zikaltrit do ta presin sfidën e parë në shtëpinë e tyre. Ndryshe është diskutimi për Romën që gjen në rrugën e vet Sevilla, një eksperte në Ligën e Evropës. Me fat edhe

Manchester Unitedi që luan kundër Laskut, ndërsa nuk mungojnë edhe sfidat e mëdha si ajo në mes të Rangersit dhe Bayer Leverkusenit. Shorti për 1/8 e Ligës së Evropës: Istanbul Basaksehir

Copenhagen, Olympiacos-Wolverhampton, Rangers-Bayer Leverkusen, Wolfsburg-Shakhtar Donetsk, Inter-Getafe, Sevilla-Roma, Eintracht / Salzburg-Bazel, LASK-Manchester United.



Plot derbi në basketboll

PRISHTINË, 28 SHKURT - Kjo fundjavë do të sjellë ndeshje shumë interesante në Superligën e Kosovës në basketboll, ku secili takim është më interesant se tjetri. Xhiroja e 26-të do të hapet me duelin Trepça - Feronikeli, dy skuadra që kanë si synim mbetjen në elitë. Të dy skuadrat kanë nga 27 pikë apo pesë fitore dhe 17 humbje, duke u renditur në vendin e shtatë, përkatësisht të tetë, andaj pritet një sfidë shumë interesante. Të shtunën në mbrëmje ballafaqohen dy skuadrat me traditë në basketbollin e Kosovës, Bashkimi dhe Sigal Prishtina.

SUPERLIGA - Java 26

Të shtunën takohen:
17:00 Trepça - Feronikeli
19:00 Bashkimi - Sigal Prishtina

Të dielën takohen:
17:00 Golden Eagle Ylli - Peja
19:00 Rahoveci - Ponte Prizreni



“Bardhekaltrit” janë liderë me 39 pikë, kurse prizrenasit ndodhen në vendin e gjashtë me katër pikë më pak. Të dielën është superndeshja ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Pejës, dy skuadra që u ballafaquan edhe në finale të Kupës, ku triumfuan pejanët. Skuadra therandase ndodhet në vendin e tretë me 38 pikë, një më pak se liderja, Prishtina, kurse skuadra prizrenase është në vendin e katërt me dy pikë më pak. Lipjani pushon në këtë xhiro.

Lakersi fiton pa LeBronin, Oklahoma mposhti Sacramenton

SAN FRANCISCO, 28 SHKURT - Skuadra e Lakersave konsolidon pozitat në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores 116-86 ndaj Golden State. Edhe pse pa LeBron Jamesin, skuadra e Lakersit ishte superiore në parket, duke dominuar në takim. Më i miri në parket ishte Davisi me 23 pikë. Fitore ka shënuar edhe Oklahoma, që mundi me rezultat 112-108 Sacramenton, ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund. Gallinari me 24 pikë ishte shënuar më i mirë për Thunderin, duke i bërë të pavlefshme 21 pikët e Barnesit përmiqjtë. Në Lindje, skuadra e Indianas fitoi me shifrat 106-100 ndaj Portlandit, takim ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. Të pestë titularët e Indianas realizuan mbi 10 pikë (Sabonis 20 pikë e 11 rebounë më i miri), ndërsa 28 pikët e McCollumit mbetën për statistikë. Pa prob-



REZULTATET

Philadelphia - New York	115-106
Indiana - Portland	106-100
Oklahoma - Sacramento	112-108
Golden State - Lakers	86-116

leme fitore ka shënuar rezultat 115-106 New Yorkun, Philadelphia, që mposhti me Harrisin që realizoi 34 pikë.

Derbi i hendbollit zhvillohet të dielën në kryeqytet

PRISHTINË, 28 SHKURT - Dy skuadra me shumë traditë në hendbollin e Kosovës takohen mes vete në kryendeshjen e javës së 17-të të Superligës së

hendbollistëve. Të dielën nga ora 18:00 takohen Prishtina e Kastrioti i Ferizajt, në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në kryeqytet. Është kjo ndeshje e

rëndësishme për kreun e tabelës. Prishtina është e dyta me 28 pikë, kurse Kastrioti i katërti me 22 pikë. Derbi përbyll javën e 17. Ndeshjet

e tjera janë të shtunën: Besa Famgas - Vushtrria (15.30), Llapi - Trepça (19:00), Drenica - Drita (19:00), Prizreni - Vëllaznimi (16:00).



SHKURT

Shtyhen ndeshjet e fundjavës në Zvicër

Koronavirusi është një nga temat më të diskutuara kohët e fundit. Ai ka mbërritur edhe në Evropë, në Itali. Frika nga ky virus ka prekur edhe futbollin italian, pasi është marrë vendim që ndeshjet e kësaj jave të luhen pa tifozë. Megjithatë, paniku nuk ka përfshirë vetëm Italinë, por edhe shtetin e Zvicrës. Zvicranët kanë marrë vendim që ndeshjet e fundjavës të shtyhen, pasi dëshirojnë t'i shmangen sa më shumë infektimit nga ky virus.

Ronaldo: Mund ta përbysim rezultatin ndaj Lyonit

Cristiano Ronaldo ka bërë me dije se nuk janë të lumtur pas humbjes 1-0 në ndeshjen e parë kundër Olympique Lyonit. Portugezi ka shprehur besimin se “Zonja e Vjetër” mund ta përbysë rezultatin dhe të kualifikohet në fazën tjetër. “Këto gjëra mund të ndodhin, është futboll. Nuk jemi të lumtur që kemi humbur, por është normale. Ndeshet e Ligës së Kampionëve janë të vështira. Ne jemi të zhgënjer, por ne kemi ndeshjen e dytë në shtëpi dhe kemi vetëbesim. Jemi të relaxuar, të fokusuar dhe të përgatitur për ndeshjen tjetër kundër Interit” ka thënë Ronaldo.

Neymar sërish hedh në gjyq Barcelonën

Pavarësisht se qarkullojnë ende zëra për një rikthim të mundshëm të Neymarit në Barcelonë, nga Spanja vjen një lajm që i befason të gjithë. Sipas asaj që raporton “El Mundo”, brazilianni ka hapur një çështje të re me klubin blaugrana, duke i dërguar 6.5 milionë euro. Para që lidhen me mosmarrëveshjen me autoritetet tatimore spanjolle për regjistrimin e tij në La Liga në vitin 2013. Kjo është beteja e tretë ligjore e brazilianit me Barcelonën, teksa më parë ka pretenduar një dëmshpërbirim prej 32.1 milionë eurosh për pagat e prapambetura dhe komision përbalanë e tij. Edhe pse dëshira e tij është që të rikthehet te klubi katalanas, duket se ai nuk ka ndërmend që të heqë dorë nga kërkësat e tij. Në verë duket i vështirë një ribashkim me Messin, në këto kushte kur palët vijonë gjyqet mes tyre.

Puyol: Guardiola do ta fitojë Ligën e Kampionëve

Ish-kapiteni i Barcelonës, Carles Puyol, ka thënë se ai është i bindur që Pep Guardiola do ta fitojë sërish trofeun e Ligës së Kampionëve për herë të tretë në karrierë, edhe pse nuk është i sigurt nëse këtë do ta arrijë me Manchester Cityn. “Për mua, Pep është trajneri më i mirë që e kam pasur dhe trajneri më i mirë në botë. Ju mund ta kuptoni menjëherë nëse një skuadër është stërvitur nga Pep duke parë nga mënyra se si luan ajo skuadër. Për këtë arsyë jam i bindur se ai do ta fitojë atë titull sërish”, ka thënë Puyol. “Nuk mund ta di nëse do të arrijë ta fitojë tani me Manchester Cityn, por ata do të fokusohen shumë në atë garë, pasi që është praktikisht e pamundur ta arrijnë Liverpoolin tani në Premierligë”, ka deklaruar Puyol.



MITROVICA
KOMPANIJA UJESJELLESI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

D P A
Departamenti për punë administrative
Mitrovicë / Nr.

Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MF-NR.07/2017, me datën 28.02.2020 mori vendim për të shpallë:

KONKURS

(Per plotësimin e vendeve te lira te punës, punë provuese 6 muaj me mundësi vazhdimi)

1. Një(1) Referent/e për Menaxhimin e Kontartave të Konsumatorëve
2. Tre (3) Lexues të Ujëmatësve
3. Tre (3) Punëtor Fizik

1. Një(1) Referent/e për Menaxhimin e Kontartave të Konsumatorëve-Pershkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës:

- përkuqdeset dhë çështë përgjicët që mban kontakte te vazhdueshme me Konsumatorët me kontrata
- pranon shkresat dhe dokumentet e ndryshme nga konsumatoret lidhur me kontratat dhe i dërgon tek personi përgjegjes ne KRUM,
- merr pjesë ne mbledhjet e organizuara nga shërbimi me Konsumator dhe raporton tek mbikqyresi i tij për ecurit dhe zhvillimet e reja,
- dërgon shkresat, kërkesat dhe raportet si dhe dokumentet e tjera nga KRUM ne Institucionet tjera,
- ne bashkëpunim me departamentet e Kompanisë bene pergaditjen e dokumentacionit te nevojshëm per Permbarim ,
- përcjell Kontratat e Konsumatorëve a po ju përbahen pagesave te borxhit,
- njoston konsumatoret ne menyr elektronike ose nepermejt telefonit për mos respektimin e kontratave,
- ne bashkëpunim me Zyrën Ligjore i jep propozimet për dërgim ne përbarim te konsumatorëve qe s'ju përbahen kontratave,
